



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 98

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 4 korrik 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 27.6.2018	Për miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2017..... 6171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 27.6.2018	Për miratimin e rregullores “Për veprimtarinë e standardizimit”..... 6181
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 27.6.2018	Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2018..... 6186
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 27.6.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 70, datë 12.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës për pajisjen me certifikatë regjistrimi në punë”..... 6187
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 385, datë 27.6.2018	Për disa shtesa në vendimin nr. 285, datë 13.4.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Hidrocentrali i Banjës–Gramsh dhe Ura e Trashovicës’”..... 6189
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 27.6.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 37, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV Gjiri i Lalëzit, Durrës”, të ndryshuar..... 6190
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 387, datë 27.6.2018	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion/partneritet publik privat për “Projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot–Balldren”..... 6191

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 27.6.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lëndfillet e mbetjeve”.....	6191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 27.6.2018	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Rushiti kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 23136/13).....	6208
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 27.6.2018	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 21.4.2016, për çështjen “Topallaj kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 32913/03).....	6208
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 27.6.2018	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Hatija kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 53103/15).....	6209
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 394, datë 27.6.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 440, datë 17.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e standardeve, të kriterëve dhe procedurave të akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë”.....	6210
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 480, datë 25.6.2018	Për delegim kompetence.....	6210
	Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasen Dhurate Nikshiqi	6211
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Edmond Dinaku	6211

**VENDIM****Nr. 381, datë 27.6.2018****PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR
PËR NDIHMAT SHTETËRORE
TË VITIT 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja “dh”, 18, shkronja “e”, dhe 32, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor për ndihmat shtetërore të vitit 2017, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**RAPORTI VJETOR
PËR NDIHMAT SHTETËRORE
TË VITIT 2017****I. PËRMBLEDHJE**

Raporti vjetor për ndihmat shtetërore është hartuar në zbatim të detyrimeve të sanksionuara në nenin 71, pika 5 të MSA-së dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Raporti është përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore. Në mënyrën e paraqitjes dhe analizës së të dhënave në raport është ndjekur metodologjia e Komisionit Evropian.

Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga dhënësit e ndihmës shtetërore: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Pavarësisht se ky raport është për vitin 2017, në të gjenden të dhëna për të gjithë periudhën 2014–2017, duke bërë një krahasim të ndihmës shtetërore, përgjatë këtyre viteve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në raport

me ndihmën shtetërore, të dhënë në vendet e BE-së (kreu 3).

Raporti jep një përshkrim të objektivave kryesore që janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore në Shqipëri, si dhe të instrumentet kryesore të përdorura në periudhën 2014–2017. Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2014–2017 është vlerësuar në rreth 10,9 miliardë lekë (82.28 milionë €), prej të cilave 2.5 miliardë lekë (16.88 milionë €) që përfaqësojnë 0,14% të PBB-së, janë dhënë në vitin 2017. Në totalin e ndihmës së dhënë për vitin 2017, vendin kryesor (rreth 63.1%) e zënë ndihmat sektoriale, në ndryshim nga vendet e BE-së ku, mbi 94% të ndihmës gjithsej është dhënë në kategoritë e ndihmave për realizimin e objektivave horizontale (ndihmë e mirë). Megjithatë, pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin *de minimis* të Bashkimit Evropian dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë periudhës 2014–2017 janë grantet dhe përjashtimi nga taksat, rimbursimi apo reduktimi i shkallës tatimore.

Paraqitja dhe vlerësimi i të dhënave të ndihmës shtetërore në këtë raport është parë në një kontekst dinamik, duke marrë parasysh zhvillimin ekonomik të vendit. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh objektivat strategjikë dhe përparësitë në zhvillimin e politikës industriale për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, ka të ngjarë që modelet e shpërndarjes së skemave të ndihmës, në të ardhmen, të ndryshojnë. Raporti u tregon apo u sugjeron autoriteteve shqiptare/dhënësve të ndihmës rëndësinë e përgatitjes së skemave në bazë të zhvillimit shumëvjeçar dhe që të synojnë kryesisht drejt realizimit të objektivave horizontale dhe me ndikim në shumë sektorë të ekonomisë apo rajone të vendit.

Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, Raporti Vjetor për Ndihamat Shtetërore për vitin 2017 do t’i përcillet Komisionit Evropian.



II. PËRKUFIZIMI I NDIHMËS SHTE-TËRORE

- Baza ligjore

Në Shqipëri, ligji i ndihmës shtetërore përcakton rregullat e dhënies së ndihmës shtetërore duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ligji i ndihmës shtetërore nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, jep përkufizimin e ndihmës shtetërore, kushtet për miratimin e ndihmës shtetërore, kompetencat e strukturave përgjegjëse, procedurën e autorizimit, monitorimin dhe kthimin e ndihmës shtetërore si edhe detyrimin për hartimin e raportit vjetor për ndihmën shtetërore.

- Përkufizimi i ndihmës shtetërore

Në bazë të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, përcaktohet se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

- Përfitues i ndihmës shtetërore

Përfitues i ndihmës shtetërore është çdo ndërmarrje ose individ që, nëpërmjet akteve dhe masave të ndërmarrja nga shteti, siguron përfitime financiare. Në përcaktimin nëse një masë është ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të

ndryshuar, dhe të nenit 107 (1) të TFEU-së, strukturat e ndihmës shtetërore vlerësojnë plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

- masa duhet të jepet nga shteti dhe të përfshijë burimet shtetërore;

- masa duhet të japë një avantazh ndaj ndërmarrjeve të caktuara ose sektorëve të caktuar; si edhe

- masa ndikon në konkurrencë dhe mund të ndikojnë në tregtinë midis shteteve anëtare.

- Çfarë nuk përbën ndihmë shtetërore?

a) *Ndihma për organet publike dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, të cilat kryejnë një aktivitet joekonomik;*

b) *Masa të përgjithshme të destinuara për të gjitha ndërmarrjet dhe të gjithë sektorët e ekonomisë në vend, të tilla si masat tatimore të përgjithshme etj.;*

c) *Prokurimi i mallrave dhe i shërbimeve me çmimin e tregut.*

2.2 Metodologjia për raportimin e ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale përfshin:

- ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion;

- ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

- ndihmën për punësim;

- ndihmën për trajnim;

- ndihmën operacionale;

- ndihmën për sportin;

- ndihmën për kulturën.

Ndihma shtetërore sektoriale përfshin:

- ndihmën për transportin publik;

- ndihmën për shërbimin publik;

- ndihmën për minierat;

- ndihmën për energjinë;

- ndihmën për turizmin.

Ndihma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente, si:

A1 – Subvencione dhe grante;

A2 – Përrjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulje e shkallës së tatimit ose zbritje e kontributit në sigurimet shoqërore.

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

III. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2017

3.1 Vështrim mbi ndihmën shtetërore në periudhën 2014–2017

A. Ndhimja shtetërore krahasuar me treguesit kryesorë socio-ekonomikë

Tabela nr. 1: Ndhimja shtetërore krahasuar me disa tregues socio-ekonomikë 2014–2017

Treguesit	Njësia e matjes	2014	Shkalla e ndihmës 2014	2015	Shkalla e ndihmës 2015	2016	Shkalla e ndihmës 2016	2017	Shkalla e ndihmës 2017
PBB	mln lekë	1,394	0.23	1,435	0.26	1,530	0.11	1,555	0.14
Shpenzimet nga buxheti i shtetit	mln lekë	438,849.00	0.74	437,408	0.86	450,224	0.38	474,100	0.47
Të punësuar	nr	925,000	3,517	973,000	3,847	1,157,210	1,485	1,160,506	1,938
Popullsia	nr	2,885,792	1,127	2,875,592	1,302	2,876,591	597	2,878,977	781
Ndhimja shtetërore	mln lekë	3,252.78		3,742.81		1,718.70		2,249.37	


Burimi: MFE

Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej në Shqipëri në periudhën 2014–2017, të krahasuara me disa tregues. Ndhimja shtetërore në vlerë absolute e dhënë në vitin 2017 është rritur me 31% e krahasuar me vitin 2016. Shkalla e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së u rrit nga 0.11% më 2016-n, në 0.14% në vitin 2017.

Ndhimja shtetërore gjithsej në vitin 2017 është dhënë në vlerën totale 2,249.37 mln lekë (16.88 mln euro).

Grafiku nr. 1 paraqet shkallën e ndihmës shtetërore ndaj PBB për periudhën 2014–2017.

Grafiku nr. 1: Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB 2014–2017





B. Ndihma shtetërore në Shqipëri e krahasuar me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian

Tabela nr. 2: Ndihma shtetërore 2014–2016

Burimi: Komisioni Evropian, DG Competition² dhe MFE (mln euro/%)

Shteti	Viti 2015	Shkalla ndaj PBB	Viti 2016	Shkalla ndaj PBB
Shqipëria	27.19	0.26	12.71	0.11
EU (28 shtetet anëtare))	93,590.10	0.63	97,298.80	0.65
Belgium	1,985.00	0.48	2,420.50	0.57
Bulgaria	330.60	0.73	293.40	0.61
Czech Republic	1,935.00	1.15	2,300.30	1.30
Denmark	3,279.40	:	4,435.60	:
Germany	35,799.50	:	39,939.80	:
Estonia	193.90	0.95	172.50	0.82
Ireland	426.80	0.16	392.40	0.14
Greece	2,191.60	1.24	630.40	0.36
Spain	2,223.50	0.21	2,284.20	0.20
France	15,652.20	0.71	13,935.20	0.63
Croatia	262.40	0.60	436.10	0.95
Italy	3,007.10	0.18	2,994.20	0.18
Cyprus	120.40	0.68	119.60	0.66
Latvia	536.10	2.20	363.30	1.46
Lithuania	298.50	0.80	323.20	0.84
Luxembourg	149.10	0.29	144.50	0.27
Hungary	1,291.60	1.17	2,213.70	1.95
Malta	91.60	0.99	54.20	0.55
Netherlands	1,771.70	0.26	1,816.10	0.26
Austria	1,788.00	0.52	1,844.80	0.52
Poland	3,373.80	0.78	4,313.40	1.01
Portugal	872.50	0.49	621.80	0.34
Romania	1,228.00	0.77	1,029.40	0.61
Slovenia	422.60	1.09	300.90	0.74
Slovakia	409.50	0.52	360.90	0.44
Finland	1,568.10	0.75	1,646.60	0.76
Sweden	3,167.50	0.71	3,610.20	0.78
United Kingdom	9,214.20	0.35	8,301.60	0.35

Tabela nr. 2 paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për vitet 2015 dhe 2016. Në tabelë janë përfshirë të dhënat e publikuara nga Komisioni Evropian në vitin 2016 për ndihmën shtetërore duke përjashtuar ndihmën që kanë dhënë shtetet anëtare për përballimin e krizës ekonomike dhe transportin.

Ndihma përfshin shpenzimet që ka kryer çdo shtet anëtar, e cila është orientuar për realizimin e objektivave horizontale me interes të përbashkët, ndihmën e dhënë për sektorët të ndryshëm të ekonomisë, si p.sh. transporti, si edhe ndihmën për arritjen e objektivave të veçantë, si p.sh. shpëtim dhe ristrukturim, ndihmën për mbylljen e ndërmarrjeve, duke përjashtuar ndihmën për sektorin e hekurudhave.

3.2 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:

- ndihmë shtetërore horizontale; dhe
- ndihmë shtetërore sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomik, ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.


Ndihma shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

² http://ec.europa.eu/competition/state_aid/scoreboard/index_en.html

**Tabela nr. 3:** Ndhima shtetërore gjithsej 2014–2017 ndarë sipas kategorive (mln lekë)

Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE


KATEGORIA	2014			2015			2016			2017		
	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %	mln lekë	mln euro	në %
Ndihma Horizontale	2,137.53	15.26	65.7%	2,835.86	20.60	75.8%	827.00	6.11	48.1%	830.58	6.23	36.9%
Punësimi	150.08	1.07	4.6%	285.34	2.07	7.6%	183.57	1.36	10.7%	196.79	1.48	8.7%
Trajnim	109.84	0.78	3.4%	136.69	0.99	3.7%	279.23	2.06	16.2%	276.98	2.08	12.3%
Sport	644.00	4.60	19.8%	2,058.00	14.95	55.0%	167.00	1.23	9.7%	218.80	1.64	9.7%
Kultura	-	-	-	41.15	0.30	1.1%	111.27	0.82	6.5%	39.58	0.30	1.8%
Ndihma operacionale	836.33	5.97	25.7%	38.36	0.28	1.0%	-	-	0.0%	5.02	0.04	0.2%
Kërkim, zhvillim dhe SME	359.82	2.57	11.1%	247.27	1.80	6.6%	19.00	0.14	1.1%	46.08	0.35	2.0%
Ndihma Sektoriale	1,115.25	7.96	34.3%	906.95	6.59	24.2%	891.70	6.59	51.9%	1,418.79	10.65	63.1%
Transport publik	440.00	3.14	13.5%	440.00	3.20	11.8%	390.00	2.88	22.7%	400.00	3.00	17.8%
Shërbimi publik	450.00	3.21	13.8%	430.00	3.12	11.5%	428.70	3.17	24.9%	974.90	7.32	43.3%
Energjia	195.25	1.39	6.0%	-	-	0.0%	-	-	-	-	-	-
Minierat	30.00	0.21	0.9%	36.95	0.27	1.0%	39.35	0.29	2.3%	35.00	0.26	1.6%
Turizmi	-	-	-	-	-	0.0%	33.65	0.25	2.0%	8.89	0.07	0.4%
TOTALI	3,252.78	23.22	100	3,742.81	27.19	100	1,718.70	12.71	100	2,249.37	16.88	100

Grafiku nr. 2: Ndhima shtetërore sipas kategorive 2014–2017

Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 2, tregojnë se në vitin 2017 ndihma shtetërore sektoriale zë pjesën më të madhe të ndihmës shtetërore gjithsej me 63.1%, ndërsa kategoria e ndihmave horizontale përbën 36.9%.

Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme të ndihmës shtetërore në vitin 2017 u rritën me rreth 31% krahasuar me shpenzimet e vitit 2016 (+ 530.67 mln lekë). Ky ndryshim i përgjithshëm është si rezultat i faktorëve, si: 1. Rritje e ndihmës shtetërore për punësimin prej rreth 13.22 mln lekësh; 2. Ulje e ndihmës shtetërore për trajnimin prej 2.25 mln lekësh; 3. Rritje e ndihmës shtetërore për mbështetjen e sportit prej 51.8 mln lekësh; 4. Ulje e ndihmës shtetërore për kulturën prej 71.69 mln lekësh; 5. Rritje e ndihmës operacionale prej 5.02 mln lekësh; 6. Rritja e ndihmës shtetërore për kërkimin dhe zhvillimin prej 27.08 mln lekësh; 7. Ulje e ndihmës shtetërore për SME-të prej 19.6 mln lekësh; 8. Rritje e ndihmës shtetërore për transportin hekurudhor prej 10 mln lekësh; 9. Rritje e ndihmës shtetërore për shërbimin publik (ujësjellësit) prej 546.2 mln lekësh; 10. Ulje e ndihmës shtetërore për minierat prej 4.35 mln lekësh; 11. Ulje e ndihmës shtetërore për mbështetjen e turizmit prej 24.76 mln lekësh.


Grafiku nr. 3 paraqet ndryshimin gjithsej të shpenzimeve të ndihmës shtetërore sipas objektivave ndërmjet 2016-s dhe 2017-s në Shqipëri (në milionë lekë).

Grafiku nr. 3: *Ndryshimi i ndihmës mes vitit 2017–2016**Burimi: MFE***3.2.1 Ndihma shtetërore horizontale**


Në vitin 2017 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 830.58 mln lekë (6.23 mln euro). Peshën më të madhe për këtë kategori të ndihmës e ka ndihma për trajnim me 12.3%.

Tabela nr. 4: *Ndihma shtetërore horizontale 2014–2017**Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE*

Ndihma Horizontale	2014		2015		2016		2017	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
Punësimi	150.08	1.07	285.34	2.07	183.57	1.36	196.79	196.79
Trajnim	109.84	0.78	136.69	0.99	279.23	2.06	276.98	276.98
Sport	644.00	4.60	2,058.00	14.95	167.00	1.23	218.80	218.80
Kultura	-	-	41.15	0.30	111.27	0.82	39.58	39.58
Ndihma operationale	836.33	5.97	38.36	0.28	-	-	5.02	5.02
Kërkim, zhvillim dhe inovacion	359.82	2.57	247.27	1.80	19.00	0.14	46.08	46.08
SME	37.46	0.27	29.05	0.21	66.93	0.49	47.33	47.33
TOTALI	2,137.53	15.26	2,835.86	20.60	826.99	6.11	830.58	830.58

Grafiku nr. 4: *Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale 2014–2017*

Grafiku nr. 5: Struktura e ndihmës shtetërore horizontale për vitin 2017



Ndiqma horizontale në vitin 2017 është në vlerën 830.58 mln lekë. Në mënyrë më të detajuar të dhënat për ndihmën shtetërore jepen më poshtë:

Ndiqma për punësim: Ndiqma për punësim jepet nëpërmjet 6 skemave të ndihmës shtetërore. Skemat janë të miratuara me vendime të Komisionit të Ndiqmes Shtetërore, si më poshtë:

1. Vendimin e KNSH-së nr. 9, datë 2.2.2007, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda apo jashtë vendit”;

2. Vendimin e KNSH-së nr. 11, datë 15.3.2007, “Për skemën ekzistuese, “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë””;

3. Vendimin e KNSH-së nr. 38, datë 19.9.2011, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore, “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta””;

4. Vendimin e KNSH-së nr. 39, datë 19.9.2011, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë””;

5. Vendimin e KNSH-së nr. 47, datë 28.3.2014, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar””;

6. Vendimin e KNSH-së nr. 62, datë 14.12.2015, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore, “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit””.

Nga skema e ndihmës shtetërore me qëllim nxitjen e punësimit kanë përfituar gjithsej 432

ndërmarrje, duke punësuar gjithsej 3040 punëkërkues të papunë, e detajuar si më poshtë:

- Nga skema e punësimit të punëkërkuesve që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit kanë përfituar gjithsej 598 punëkërkues të papunë.

- Nga skema e punësimit të punëkërkuesve të papunë nga grupe të veçanta kanë përfituar 332 ndërmarrje, duke u punësuar 2307 punëkërkues të papunë.

- Nga skema e punësimit të punëkërkuesve gra dhe vajza nga grupet e veçanta kanë përfituar gjithsej 10 ndërmarrje, duke u punësuar 10 punëkërkues të papunë.

- Nga skema e punësimit të punëkërkuesve të rinj kanë përfituar gjithsej 33 ndërmarrje, duke punësuar 44 punëkërkues të papunë.

- Nga skema e punësimit të punëkërkuesve me aftësi të kufizuara kanë përfituar gjithsej 55 ndërmarrje, duke krijuar gjithsej 79 vende të reja pune.

- Nga skema e punësimit të punëkërkuesve me statusin e jetimit kanë përfituar gjithsej 2 ndërmarrje, duke u krijuar 2 vende të reja pune.

Ndiqma për trajnim. Skema e ndihmës shtetërore, e miratuar me vendimin e KNSH nr. 12, datë 15.3.2007, “Për skemën ekzistuese, “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë””, ka si qëllim trajnimin e punëkërkuesve të cilët më pas sigurojnë vendin e tyre të punës në ndërmarrjet të cilat janë përfituese të ndihmës shtetërore. Në vitin 2017 kanë përfituar gjithsej 121 ndërmarrje duke u trajnuar 2224 punëkërkues të papunë, janë dhënë 279,23 milionë lekë. Për këtë skemë të ndihmës



shtetërore janë shpenzuar fonde nga buxheti i shtetit gjithsej në shumën 276.98 mln lekë.

Ndihma për sportin. Komisioni me vendimin nr. 54, datë 26.1.2015, “Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit”. Për këtë skemë ndihmë, objektivi kryesor, i së cilës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, për vitin 2017 janë shpenzuar nga buxheti i shtetit 218.8 milionë lekë.

Përfituesit e skemës janë federatat e ndryshme sportive që ofrojnë shërbime sportive për anëtarët e tyre dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. Federatat shqiptare të sportit janë organizata jofitimprurëse, të cilat kanë për qëllim të zhvillojnë, të promovojnë, të kontrollojnë dhe të rregullojnë aktivitetet sportive të shoqatave dhe klubeve, të cilat janë anëtare të federatave të tyre, në përputhje me statutet e tyre.

Mbështetja me grante nga buxheti i shtetit jepet, për:

- Federatat e ndryshme të sportit – financimin për mbulimin e kostove të personelit dhe investimeve;

- Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar – financimin për pjesën e kostos së mbuluar të personelit.

Ndihma për nxitjen e kulturës. Në vitin 2017 ndihma shtetërore për nxitjen e kulturës është dhënë në vlerën 39.58 mln lekë. Ndihma shtetërore është dhënë në formën e mbështetjes financiare me fonde publike për projektet me thirrje dhe në zbatim të prioritetëve institucionale në programin e fushës së art-kulturës. Objektivi i ndihmës është mbështetja e projekteve kulturore për individë dhe subjekte që në veprimtarinë e tyre kanë artin dhe kulturën në disiplinën të ndryshme artistike, si: teatër, muzikë, artet pamore, hulumtimin, ngritje infrastrukturore (rritje kapaciteteve).

Ndihma operacionale. Kjo kategori përfshin skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse të konsumuara në serrat me ngrohje dhe industrinë. Për vitin 2017, Ministria e Financave për këtë kategori raporton se nga zbatimi i skemës është dhënë ndihmë në shumën 5.02 mln

lekë dhe se nga skema e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serrat me ngrohje dhe industrinë.

Ndihma për kërkim dhe zhvillim. Sipas raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ndihma shtetërore për kërkim dhe zhvillim është dhënë për ndërmarrjet që nënshkruajnë “marrëveshje hidrokarburesh” dhe nënkontraktuesit e tyre, duke iu ofruar një përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar të të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve për realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure. Në vitin 2017, është raportuar se kompanitë e huaja që kryejnë operacione hidrokarbure në Shqipëri kanë përfutur përjashtime në import (TVSH dhe përjashtime doganore), në shumën 46.08 mln lekë (në vitin 2016 shumën e përjashtimeve ishte 19 mln lekë).

Ndihma për SME. Në vitin 2017 nga skema e ndihmës shtetërore për SME-të kanë përfutur gjithsej 66 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, prej të cilave 27 ndërmarrje të mbështetura nga fondet e AIDA dhe 39 ndërmarrje nga skema e ndihmës shtetërore të dhënë nga Bashkia e Tiranës. Vlera e ndihmës gjithsej për SME-të është 47.33 mln lekë e ndarë në:

- Fondi i ekonomisë kreative në vlerën 900,000 lekë;

- Fondi i konkurrueshmërisë në vlerën 8,324,183 lekë;

- Fondi *start-up* në vlerën 18,074,308 lekë;

- Fondi i inovacionit në vlerën 2,623,350 lekë;

- Plani i ndihmës shtetërore për gratë sipërmarrëse në Bashkinë e Tiranës në vlerën 5.34 mln lekë;

- Plani i ndihmës shtetërore për nxitjen e punësimit të krijimit të biznesit social rinor në vlerën 10 mln lekë në Bashkinë e Tiranës;

- Plani i ndihmës shtetërore për të rinjtë e të rejtat drejt në profesionin në Bashkinë e Tiranës në vlerën 2.1 mln lekë.

3.2.2 Ndihma shtetërore sektoriale


Në vitin 2017, ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 1, 418.79 mln lekë (10.65 mln euro). Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2017 është 63.1%.

Tabela nr. 5: Ndihma shtetërore sektoriale 2014–2017


Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Ndihma sektoriale	2014		2015		2016		2017	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
Transporti publik	440.00	3.14	440.00	3.20	390.00	2.88	400.00	3.00
Shërbime publike	450.00	3.21	430.00	3.12	428.70	3.17	974.90	7.32
Energjia	195.25	1.39	-	-	-	-	-	-
Minierat	30.00	0.21	36.95	0.27	39.35	0.29	35.00	0.26
Turizmi	-	-	-	-	33.65	0.25	8.89	0.07
TOTALI	1,115.25	7.96	906.95	6.59	891.70	6.59	1,418.79	10.65

Grafiku nr. 6: Ecuria e ndihmës shtetërore sektoriale 2014–2017



Grafiku nr. 7: Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2017





Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2017, peshën më të lartë e zë ndihma për shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve), duke vijuar me ndihmën për transportin publik (hekurudha) dhe ndihmën për minierat (në mbyllje dhe konservim).

Ndihma për transportin publik është dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor është 400 mln lekë në vitin 2017, kundrejt 390 mln lekë për vitin 2016.

Ndihma për shërbimet publike: Në vitin 2017 ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizime në shumën 974.9 milionë lekë.

Ndihma për minierat: Ndihma për minierat nga buxheti i shtetit për vitin 2017 jepet për vazhdimin e mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe joefektive, privatizimi i aseteve për të mundësuar monitorimin e fenomeneve të postshfrytëzimit në shumën 35 mln lekë.

Ndihma për turizmin: Në vitin 2017, sektori i turizmit përfitoi 8.89 mln lekë. Instrumenti i ndihmës është grante nga buxheti i shtetit, në

programin “Fondi për mbështetjen e turizmit”. Përfitues të ndihmës janë subjekte publike dhe organizata jofitimprurëse.

IV. INSTRUMENTET E SHPËRNDARJES SË NDIHMËS SHTETËRORE

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike duke pasur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2017, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe incentivave fiskale. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE-ja, instrumentet e ndihmës shtetërore klasifikohen në:

A1 – Subvencione dhe grante;

A2 – Përfashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B – Pjesëmarrja në kapital;

C1 – Hua të buta;

C2 – Instrumente të tjera;


D – Garancitë.

Tabela nr. 6: Ndihma shtetërore gjithsej sipas instrumenteve
Burimi: Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, MFE

Kategoria e ndihmës	Subvencione dhe Grante (A1)	Përfashtim nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2)
Ndihma Horizontale		
<i>Punësimi</i>	196.79	
<i>Trajnim</i>	276.98	
<i>Sport</i>	218.80	
<i>Kultura</i>	39.58	
<i>Ndihma operacionale</i>		5.02
<i>Kërkim, zhvillim dhe inovacion</i>		46.08
<i>SME</i>	47.33	
Ndihma Sektoriale		
<i>Transport publik (Hekurudha)</i>	400.00	
<i>Shërbimi publik</i>	974.90	
<i>Energjia</i>	-	
<i>Minierat</i>	35.00	
<i>Turizmi</i>	8.89	
TOTALI	2,198.27	51.10

Të dhënat në tabelën nr. 6 tregojnë se instrumenti i përdorur më shumë është A1 - subvencione dhe grante, sikurse paraqitet edhe në grafikun nr. 8.

Grafiku nr. 8: Struktura e shpërndarjes së instrumenteve të ndihmës shtetërore për vitin 2017

**VENDIM**

Nr. 382, datë 27.6.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR VEPRIMTARINË E
STANDARDIZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për veprimtarinë e standardizimit”³, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

RREGULLORE**PËR VEPRIMTARINË E STANDARDIZIMIT****KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****1. Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton rregullat lidhur me bashkëpunimin ndërmjet organizatave evropiane të standardizimit, organeve kombëtare të standardizimit, shteteve anëtare dhe Komisionit, hartimin dhe miratimin e standardeve dhe dokumenteve evropiane të standardizimit (të publikuara nga CEN, CENELEC dhe ETSI)⁴ për produktet dhe shërbimet në mbështetje të legjislacionit dhe politikave të Bashkimit Evropian, identifikimin e specifikimeve teknike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), që përdoren për referencë, si dhe financimin nga Bashkimi Evropian për veprimtaritë e standardizimit.

2. Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje përdoren përkufizimet e dhëna në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “**Projektstandard**”, dokument që përmban tekstin e specifikimeve teknike në lidhje me një temë/fushë të caktuar, i cili miratohet në përputhje me procedurën përkatëse të standardeve dhe qarkullon për komente në publik;

³ Kjo rregullore është përafëruar plotësisht me rregulloren e Bashkimit Evropian nr. 1025/2012, të Parlamentit Evropian, dhe të Këshillit, të datës 25 tetor 2012, “Mbi standardizimin evropian, që amendon direktivat e Këshillit 89/686/EEC dhe 93/15/EEC dhe direktivat 94/9/EC, 94/25/EC, 95/16/EC, 97/23/EC, 98/34/EC, 2004/22/EC, 2007/23/EC, 2009/23/EC dhe 2009/105/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizojnë vendimin e Këshillit 87/95/EEC dhe vendimin nr. 1673/2006/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”.

⁴ CEN – Komiteti Evropian për Standardizimin; CENELEC – Komiteti Evropian për Standardizimin në fushën e elektroteknikës; ETSI – Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit.



2. “**Specifikim teknik**”, dokument që përshkruan kërkesat teknike që duhet të përmbushë një produkt, proces, shërbim ose sistem dhe që përcakton një ose më shumë nga elementet e mëposhtme:

a) Karakteristikat e kërkuara për një produkt, duke përfshirë nivelet e cilësisë, performancën, ndërfunksionimin, mbrojtjen e mjedisit, shëndetin, sigurinë ose përmasat, si dhe kërkesat e zbatueshme për produktin në lidhje me emrin me të cilin shitet produkti, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat e provës, paketimin, markimin ose etiketimin dhe procedurat për vlerësimin e konformitetit;

b) Metodatat dhe proceset e prodhimit që përdoren në lidhje me produktet bujqësore, produktet e synuara për konsum nga njerëzit e kafshët dhe produktet mjekësore, si edhe metodatat e proceset e prodhimit që lidhen me produkte të tjera, kur këto ndikojnë në karakteristikat e tyre;

c) Karakteristikat që kërkohen nga një shërbim, duke përfshirë nivelet e cilësisë, performancën, ndërfunksionimin, mbrojtjen e mjedisit, shëndetin ose sigurinë, përfshirë edhe kërkesat e zbatueshme për ofruesin në lidhje me informacionin që duhet t'i vihet në dispozicion marrësit;

ç) Metodatat dhe kriteret për vlerësimin e performancës së produkteve të ndërtimit, që përcaktojnë kriteret e harmonizuara për tregtimin e produkteve të ndërtimit, në lidhje me karakteristikat e tyre thelbësore;

3. “**Specifikim teknik i TIK**”, specifikim teknik në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit;

4. “**Produkt**”, çdo produkt i prodhuar në mënyrë industriale dhe çdo produkt bujqësor, duke përfshirë produktet e peshkut;

5. “**Shërbim**”, çdo veprimtari ekonomike vetëpunësimi, e cila, në kushte normale, ofrohet kundrejt shpërblimit.

KREU II

TRANSPARENCA DHE PJESËMARRJA E GRUPEVE TË INTERESIT

1. Transparenca për programet e punës së organizmave të standardizimit

1.1 DPS-ja përgatit programin e saj të punës të paktën një herë në vit. Ky program pune përmban informacione për standardet dhe dokumentet e

standardizimit që DPS-ja synon të hartojë, të adaptojë ose të amendojë, të cilat mund të jenë hartimi i projektstandardeve dhe/ose dokumenteve të reja të standardizimit ose amendimet e atyre standardeve dhe/ose dokumenteve të standardizimit që ka miratuar gjatë periudhës së programit paraardhës të punës.

3.2 Për çdo projektstandard dhe/ose dokument standardizimi, programi i punës tregon:

a) Titullin dhe fushën e zbatimit;

b) Statusin aktual të publikimeve (standardeve dhe dokumenteve të standardizimit);

c) Referencat e çdo standardi ndërkombëtar që është marrë për bazë.

3.3 DPS-ja e bën të disponueshëm programin e punës në faqen e tij të internetit ose në çdo faqe tjetër interneti të aksesueshme për publikun, si dhe bën njoftimin e jep *link*-un përkatës se ku gjendet ky program.

3.4 DPS-ja njofton organizatat evropiane të standardizimit dhe organet e tjera kombëtare të standardizimit për programin e punës, menjëherë pas botimit të tij.

3.5 DPS-ja nuk do të kundërshtojë që një projektstandard dhe/ose një dokument standardizimi i planifikuar në programin e saj të punës të diskutohet në nivel evropian, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga organet evropiane të standardizimit, dhe nuk do të ndërmarrë asnjë veprim që mund të cenojë një vendim që vjen si rezultat i këtij diskutimi.

3.6 Gjatë përgatitjes së një standardi të harmonizuar ose pas miratimit të tij, DPS-ja nuk do të ndërmarrë asnjë veprim që mund të cenojë harmonizimin e synuar dhe, në veçanti, nuk do të hartojë dhe publikojë në fushën në fjalë një standard kombëtar të ri ose të rishikuar që nuk është plotësisht në përputhje me standardin e harmonizuar ekzistues. Pas publikimit nga CEN, CENELEC dhe ETSI të një standardi të ri të harmonizuar, të gjitha standardet kombëtare, në konflikt me të, do të shfuqizohen brenda një afati kohor të arsyeshëm.

4. Transparenca për përmbajtjen e standardeve

4.1 DPS-ja u dërgon, të paktën në format elektronik, organizatave evropiane të standardizimit dhe organizatave të tjera kombëtare të standardizimit jashtë vendit ose Komisionit Evropian, çdo projekt të standardit kombëtar ose



standarde e dokumente standardizimi me kërkesën e tyre.

4.2 DPS-ja, brenda tre muajve, i përgjigjet dhe merr në konsideratë çdo koment të marrë nga çdo organizëm evropian dhe kombëtar standardizimi ose nga Komisioni Evropian në lidhje me projektet që përmenden në nënpikën 4.1 të kësaj rregulloreje.

4.3 Në rastin kur DPS-ja merr komente që tregojnë se projektstandardi mund të ketë ndikim negativ në tregun e brendshëm, DPS-ja, përpara miratimit të tij, do të konsultohet me organizatat evropiane të standardizimit dhe me Komisionin Evropian.

4.4 Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit:

a) Garanton aksesin në projektstandartet kombëtare në mënyrë të tillë që të gjitha palët përkatëse, në veçanti organet kombëtare të standardizimit të shteteve të tjera anëtare, të kenë mundësi që të paraqesin komente;

b) Lejon që organizmat e tjerë kombëtarë të standardizimit të përfshihen në mënyrë pasive ose aktive, duke dërguar vëzhgues në veprimtaritë e planifikuara në programin e punës së standardeve.

5. Aksesin i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) te standardet

5.1 DPS-ja nxit dhe lehtëson aksesin e NVM në standardet dhe në punën për hartimin/adaptimin dhe miratimin e standardeve, me qëllim që të arrihet një nivel më i lartë pjesëmarrjeje në punën kombëtare të standardizimit, nëpërmjet:

a) Identifikimit, në programet e saj të punës, të projektstandardeve dhe dokumenteve të standardizimit, me interes të veçantë për NVM;

b) Dhënies së aksesit në veprimtaritë e standardizimit, pa e detyruar NVM, që të bëhet anëtare e DPS-së;

c) Ofritit të aksesit pa pagesë ose ofritit të tarifave të veçanta për pjesëmarrje në veprimtaritë e standardizimit;

ç) Ofritit të aksesit pa pagesë të projektstandardeve;

d) Bërjes së disponueshme pa pagesë të abstrakteve të standardeve në faqet e tyre të internetit;

dh) Aplikimit të tarifave të veçanta për ofrimin e standardeve ose ofritit të një grupi standardesh me çmim të reduktuar.

5.2 DPS-ja bashkëpunon me homologët e saj të shteteve të tjera anëtare me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira në drejtim të rritjes së

pjesëmarrjes së NVM në veprimtaritë e standardizimit dhe për të rritur e lehtësuar përdorimin e standardeve nga ana e NVM.

5.3 DPS-ja u dërgon organeve evropiane të standardizimit raporte vjetore në lidhje me veprimtarinë e saj, referuar nënpikave 5.1 e 5.2 të kësaj rregulloreje, dhe të gjitha masat e tjera që ndërmer për të përmirësuar kushtet që NVM të përdorë standardet dhe të marrë pjesë në procesin e hartimit/adaptimit dhe miratimit të standardeve. DPS-ja i publikon këto raporte në faqen e saj të internetit.

6. Pjesëmarrja e autoriteteve publike në veprimtaritë e standardizimit

6.1 Qeveria, kur është e përshtatshme, nxit pjesëmarrjen e autoriteteve publike, duke përfshirë autoritetet për mbikëqyrjen e tregut në veprimtaritë kombëtare të standardizimit për hartimin/adaptimin dhe miratimin e standardeve ose për rishikimin e standardeve që kërkohen nga Komisioni.

KREU III

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË TIK-ut

7. Identifikimi i specifikimeve teknike të TIK-ut që përdoren për referencë

7.1 Me propozimin e një shteti anëtar ose me iniciativën e vet, Komisioni Evropian mund të vendosë që të identifikojë specifikime teknike të TIK-ut, që nuk janë standarde kombëtare, evropiane apo ndërkombëtare, por plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shtojcën I, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, të cilat mund të përdoren si referencë, kryesisht për të mundësuar ndërveprimin në prokurimin publik.

7.2 Kur një specifikim teknik i TIK-ut, i identifikuar në përputhje me nënpikën 7.1, ndryshohet, shfuqizohet ose nuk përmbush më kërkesat e përcaktuara në shtojcën I, Komisioni, me propozimin e një shteti anëtar ose me iniciativën e vet, mund të bëjë njoftimin për specifikimin teknik të TIK-ut që është ndryshuar ose të shfuqizojë identifikimin.

7.3 Vendimet e parashikuara në nënpikat 7.1 e 7.2 miratohen pas konsultimeve të platformës evropiane me shumë grupe interesi për standardet në fushën e TIK-ut, që përfshin organizatat evropiane të standardizimit, shtetet anëtare dhe grupet përkatëse të interesit dhe pas konsultimeve me komitetin e ngritur nga legjislacioni përkatës i



Bashkimit Evropian, nëse ai ekziston, ose pas formave të tjera të konsultimit me ekspertë të sektorit, nëse ky komitet nuk ekziston.

8. Përdorimi i specifikimeve teknike të TIK-ut në prokurimin publik

8.1 Specifikimet teknike të TIK-ut, që përmenden në pikën 7 të kësaj rregulloreje, përbëjnë specifikimet teknike të unifikuara sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV FINANCIMI I STANDARDIZIMIT EVROPIAN

9. Financimi i organizatave të standardizimit nga Bashkimi Evropian

9.1 Financimi nga Bashkimi Evropian mund t'u jepet organizatave evropiane të standardizimit për veprimtaritë e mëposhtme të standardizimit:

a) Hartimi dhe rishikimi i standardeve evropiane ose dokumenteve të standardizimit evropian që janë të nevojshme dhe të përshtatshme për mbështetjen e legjislacionit dhe të politikave të Bashkimit Evropian;

b) Verifikimi i cilësisë dhe përputhshmërisë së standardeve evropiane ose dokumenteve të standardizimit evropian me legjislacionin dhe politikën përkatëse të Bashkimit Evropian;

c) Kryerjen e punës paraprake ose ndihmëse në lidhje me standardizimin evropian, duke përfshirë studimet, veprimtaritë e bashkëpunimit, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, seminarët, vlerësimet, analizat krahasuese, punët kërkimore, punën laboratorike, testimet ndërlaboratorike, punën për vlerësimin e përputhshmërisë dhe masat për të garantuar që periudhat për zhvillimin dhe rishikimin e standardeve evropiane ose dokumenteve të standardizimit evropian të shkurtohen pa cenuar parimet themeluese, veçanërisht parimet e gjithëpërfshirjes, cilësisë, transparencës dhe konsensusit ndërmjet të gjitha grupeve të interesit;

ç) Veprimtaritë e sekretariateve qendrore të organizatave evropiane të standardizimit, duke përfshirë zhvillimin e politikave, koordinimin e veprimtarive të standardizimit, përpunimin e punës teknike dhe sigurimin e informacionit për palët e interesuara;

d) Përkthimin e standardeve evropiane ose dokumenteve të standardizimit evropian, që përdoren në mbështetje të legjislacionit dhe

politikave të Bashkimit Evropian, në gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian, të ndryshme nga gjuhët në të cilat punojnë organizatat evropiane të standardizimit ose, për raste të justifikuara, siç duhet, në gjuhë të ndryshme nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian;

dh) Përgatitjen e informacionit për të shpjeguar, interpretuar dhe thjeshtësuar standardet evropiane ose të dokumenteve të standardizimit evropian, duke përfshirë hartimin e udhëzuesve të përdoruesit, abstrakteve të standardeve, informacionit për praktikën më të mirë dhe veprimet ndërgjegjësuese, strategjitë dhe programet e trajnimit;

e) Veprimtaritë që kërkojnë të kryejnë programe të asistencës teknike, bashkëpunim me vende të treta dhe nxitjen dhe përmirësimin e sistemit evropian të standardizimit e të standardeve evropiane dhe dokumenteve të standardizimit evropian ndërmjet palëve të interesuara në nivel të Bashkimit Evropian dhe në nivel ndërkombëtar.

9.2 Financimi nga Bashkimi Evropian mund të jepet edhe për:

a) Organet kombëtare të standardizimit për veprimtaritë e standardizimit, që përmenden në nënpikën 9.1, që ata ndërmarrin bashkërisht me organizatat evropiane të standardizimit, si dhe organizatat evropiane të grupeve të interesit, të përcaktuara në shtojcën II të kësaj rregulloreje;

b) Organizma të tjerë të cilëve u është besuar kontributi për veprimtaritë që përmenden në shkronjën “a”, të nënpikës 9.1 ose që kryejnë veprimtaritë që përmenden në shkronjat “c” dhe “e”, të nënpikës 9.1, në bashkëpunim me organizatat evropiane të standardizimit.

10. Organet kombëtare të standardizimit

10.1 Qeveria informon Komisionin për organin kombëtar të standardizimit në Shqipëri dhe për çdo ndryshim që lidhet me të në rast se do të ketë.

10.2 Komisioni Evropian boton një listë të organeve kombëtare të standardizimit dhe çdo përditësim të asaj liste në gazetën zyrtare të Bashkimit Evropian.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE

11. Periudhat e zbatimit të rregullores

11.1 Pikat 1, 2, 3 (me përjashtim të nënpikës 3.4), 4, 5, 6, 8 e 9 zbatohen me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.



11.2 Pikat 7, 10 dhe nënpika 3.4 e kësaj rregulloreje aplikohen në momentin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

SHTOJCA I KËRKESAT PËR IDENTIFIKIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË TIK-ut

1. Specifikimet teknike pranohen nga tregu dhe zbatimet e tyre nuk pengojnë ndërfunksionimin me zbatimet e standardeve ekzistuese evropiane ose ndërkombëtare. Pranimi nga tregu tregohet nëpërmjet shembujve operativë ose zbatimeve të pajtueshme nga shitës të ndryshëm.

2. Specifikimet teknike janë koherente meqenëse ato nuk janë në konflikt me standardet evropiane, që do të thotë se mbulojnë fusha ku miratimi i standardeve evropiane nuk parashikohet brenda një periudhe të arsyeshme, kur standardet ekzistuese nuk janë pranuar nga tregu ose kur këto standarde janë vjetruar ose kur transpozimi i specifikimeve teknike në dokumente të standardizimit evropian nuk parashikohet brenda një periudhe të arsyeshme.

3. Specifikimet teknike janë përgatitur nga një organizatë jofitimprurëse që është një shoqëri profesionale e shoqërisë, industrisë ose tregtisë ose ndonjë organizatë me anëtarësi të ndryshme që brenda fushës së saj të ekspertizës përgatit specifikime teknike të TIK-ut dhe që nuk është një organizatë evropiane standardizimi, organ kombëtar ose ndërkombëtar standardizimi, nëpërmjet proceseve që përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) Vendimmarrjen e hapur:

Specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e një vendimmarrjeje të hapur të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara në tregun ose tregjet që preken nga këto specifikime teknike;

b) Konsensusin:

Procesi i vendimmarrjes ka qenë bashkëpunues dhe i bazuar në konsensus dhe nuk ka favorizuar asnjë grup interesi të caktuar. Konsensusi është një marrëveshje e përgjithshme e karakterizuar nga mungesa e kundërshtimit të vazhdueshëm ndaj çështjeve thelbësore nga çdo pjesë e rëndësishme e interesave të përfshirë dhe nga një proces që përfshin përpjekjet për të marrë në konsideratë pikëpamjet e të gjitha palëve të përfshira dhe rakordimin e çdo argumenti kundërshtues. Konsensusi nuk nënkupton unanimitet;

c) Transparencën:

i. të gjitha informacionet që lidhen me diskutimet teknike dhe vendimmarrjen u arkivuan dhe u identifikuan;

ii. informacionet për veprimtaritë e reja të standardizimit u shpallën publikisht dhe gjerësisht nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme dhe të aksesueshme;

iii. pjesëmarrja e të gjitha kategorive përkatëse të palëve të interesuara u kërkua për të arritur ekuilibrin;

iv. komentet nga palët e interesuara u morën në konsideratë dhe morën përgjigje.

4. Specifikimet teknike plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) Mirëmbajtjen: mbështetja e vazhdueshme dhe mirëmbajtja e specifikimeve të botuara garantohen përgjatë një periudhe të gjatë;

b) Disponueshmërinë: specifikimet janë publikisht të disponueshme për zbatim dhe përdorim sipas kushteve të arsyeshme (duke përfshirë një tarifë të arsyeshme ose pa pagesë);

c) Të drejtat e pronësisë intelektuale, që janë thelbësore për zbatimin e specifikimeve, licencohen për aplikuesit mbi baza të arsyeshme (të drejta) dhe jodiskriminuese ((F)RAND), që përfshijnë, sipas gjykimit të mbajtësit të së drejtës së pronësisë intelektuale, licencimin e pronësisë intelektuale thelbësore pa kompensim;

ç) Rëndësia:

i. specifikimet janë efikase dhe të rëndësishme;

ii. specifikimet duhet t'u përgjigjen nevojave të tregut dhe kërkesave të legjislacionit;

d) Neutraliteti dhe stabiliteti:

i. specifikimet, sa herë është e mundur, orientohen drejt performancës dhe nuk bazohen në model ose në karakteristikat përshkruese;

ii. specifikimet nuk shtrembërojnë tregun apo kufizojnë mundësitë që zbatuesit të zhvillojnë konkurrencën dhe inovacionin që bazohet tek ato;

iii. specifikimet bazohen në zhvillime shkencore dhe teknologjike të avancuara;

dh) Cilësinë:

i. cilësia dhe niveli i detajeve mjaftojnë për të lejuar zhvillimin e disa zbatimeve konkurruese të produkteve dhe shërbimeve ndërvepruese;

ii. ndërfaqet e standardizuara nuk fshihen apo kontrollohen nga askush tjetër përveç organizatave që kanë miratuar specifikimet teknike.



SHTOJCA II

ORGANIZATAT EVROPIANE TË GRUPEVE
TË INTERESIT QË KUALIFIKOHEN PËR
FINANCIM NGA BASHKIMI EVROPIAN

1. Një organizatë evropiane, e cila përfaqëson NVM në veprimtaritë evropiane të standardizimit, që:

a) Është joqeveritare dhe jofitimprurëse;

b) Ka objektivat dhe veprimtaritë e saj statutore për të përfaqësuar interesat e NVM në procesin e standardizimit në nivel evropian, për t'i ndërgjegësuar për standardizimin dhe për t'i motivuar ata që të përfshihen në procesin e standardizimit;

c) I është dhënë autoriteti nga organizatat jofitimprurëse që përfaqësojnë NVM në të paktën dy të tretat e shteteve anëtare, që të përfaqësojnë interesat e NVM-së në procesin e standardizimit në nivel evropian.

2. Një organizatë evropiane, e cila përfaqëson konsumatorët në veprimtaritë evropiane të standardizimit, që:

a) Është joqeveritare, jofitimprurëse dhe e pavarur nga interesat industriale, tregtare dhe të biznesit dhe interesa të tjera konfliktuese;

b) Ka objektivat dhe veprimtaritë e saj statutore për të përfaqësuar interesat e konsumatorëve në procesin e standardizimit në nivel evropian;

c) I është dhënë autoriteti nga organizatat kombëtare jofitimprurëse që përfaqësojnë konsumatorët në të paktën dy të tretat e shteteve anëtare, që të përfaqësojnë interesat e konsumatorëve në procesin e standardizimit në nivel evropian.

3. Një organizatë evropiane, e cila përfaqëson interesat mjedisore në veprimtaritë evropiane të standardizimit, që:

a) Është joqeveritare, jofitimprurëse dhe e pavarur nga interesat industriale, tregtare dhe të biznesit dhe interesa të tjera konfliktuese;

b) Ka objektivat dhe veprimtaritë e saj statutore për të përfaqësuar interesat mjedisore në procesin e standardizimit në nivel evropian;

c) I është dhënë autoriteti nga organizatat kombëtare mjedisore jofitimprurëse në të paktën dy të tretat e shteteve anëtare, që të përfaqësojnë interesat mjedisore në procesin e standardizimit në nivel evropian.

4. Një organizatë evropiane, e cila përfaqëson interesat shoqërore në veprimtaritë evropiane të standardizimit, që:

a) Është joqeveritare, jofitimprurëse dhe e

pavarur nga interesat industriale, tregtare dhe të biznesit dhe interesa të tjera konfliktuese;

b) Ka objektivat dhe veprimtaritë e saj statutore për të përfaqësuar interesat shoqërore në procesin e standardizimit në nivel evropian;

c) I është dhënë autoriteti nga organizatat kombëtare shoqërore jofitimprurëse në të paktën dy të tretat e shteteve anëtare, që të përfaqësojnë interesat shoqërore në procesin e standardizimit në nivel evropian.

VENDIM

Nr. 383, datë 27.6.2018

**PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT
TË PUNONJËSVE ORGANIKË NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE
PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2018, shtohet me 4 punonjës për Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, duke e çuar numrin e përgjithshëm të Ministrisë në 1951 veta.

2. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për vitin 2018, shtohet me 9 punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të Ministrisë në 4271 veta.

3. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2018, shtohet me 3 punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 14149 veta.

4. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2018, shtohet me 21 punonjës për Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, duke e çuar numrin e përgjithshëm të Ministrisë në 1101 veta.

5. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për vitin 2018, reduktohet me 21 punonjës të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, duke e çuar numrin e përgjithshëm të Ministrisë në 5705 veta.

6. Numri i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për vitin 2018, reduktohet me 16 punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 315 veta.



7. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura më sipër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 384, datë 27.6.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 70, DATË 12.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË REGJISTRIMI NË PUNË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, e 73, pika 4, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 70, datë 12.2.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, fjalët “... drejtoria që ka në përgjegjësi çështjet e migracionit në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ...”, zëvendësohen me “... zyra përkatëse e punësimit ose Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, e ushtron veprimtarinë ekonomike në më shumë se një rajon gjeografik ...”.

2. Shkronja “a”, e pikës 3, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“a) Kërkesën për pajisje me certifikatë regjistrimi në punë, sipas formatit të dhënë në aneksin që i bashkëlidhet këtij vendimi;”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. Zyra përkatëse e punësimit ose Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëse vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga personat e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, është i plotë apo, pas plotësimit të tij brenda afatit të përcaktuar, i përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, e pajis të huajin me certifikatën e regjistrimit në punë, sipas formatit për punësim, të miratuar me urdhër të ministrit të

ngarkuar me çështjet e migracionit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.”.

4. Pika 9 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“9. Nëse kërkesa është paraqitur pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin e origjinës së të huajt ose pranë përfaqësisë diplomatike që mbulon vendin e tij të origjinës, kjo e fundit, nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, përcjell dokumentacionin në ministrinë që ka në fushën e përgjegjësisë çështjet e migracionit për punësim, e cila e dërgon kërkesën pranë zyrës përkatëse të punësimit/Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.”.

5. Pika 10 ndryshohet si më poshtë vijon:

“10. Zyra përkatëse e punësimit ose Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për pranimin/refuzimin e të huajt për pajisje me certifikatë regjistrimi në punë, ndjek procedurat e përcaktuara në pikat 5, 6, 7, e 8 të këtij vendimi, dhe ia përcjell njoftimin për pranimin/refuzimin e kërkesës së të huajt ministrisë që ka në ngarkim çështjet e migracionit për punësim.”.

6. Pika 11 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“11. Ministria, që ka në ngarkim çështjet e migracionit për punësim, përcjell në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme njoftimin për pranimin/refuzimin e kërkesës së të huajt për t'u pajisur me certifikatë regjistrimi në punë.”.

7. Pika 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“12. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme njofton përfaqësinë diplomatike në vendin e origjinës së të huajt për pranimin/refuzimin e kërkesës së të huajt për pajisje me certifikatë regjistrimi në punë.”.

8. Pika 16 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“16. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit bën regjistrimin e të huajve, sipas nenit 73, pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar.”.

9. Pika 18 ndryshohet si më poshtë vijon:

“18. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strukturat në varësi të tyre për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi



ANEKS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISËREPUBLIC OF ALBANIA
MINISTRY OF FINANCE AND ECONOMYSHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT / ZYRA E PUNËSIMIT
NATIONAL EMPLOYMENT SERVICE / EMPLOYMENT OFFICE

FORMULAR – KËRKESË/APPLICATION

Për lëshimin e certifikatës së regjistrimit një të huaji/For issuance of a registration certificate to a
foreigner

1. TË DHËNAT E PUNËDHËNËSIT / INFORMATION ABOUT THE EMPLOYER

1. Emri i punëdhënësit/organizatës _____
Name of the employer/organisation2. Vendi dhe adresa e punëdhënësit/organizatës _____
Seat and address of the employer/organisation3. Numri i regjistrimit në ISSH /___/___/___/___/___/___/___/___/___/___/
Registration number in the Cr Health Insurance Institute4. Kodi fiskal NIPT/___/___/___/___/___/___/___/___/___/___/___/___/___/___/
Business activity codea) Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment orb) Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit: _____
Abstract from National Business Centre5. Data e menduar e fillimit dhe e përfundimit të punës /___/___/___/___/___/___/___/___/
deri në /___/___/___/___/___/___/___/___/
Period for which the certificate of registration is requested from to6. Emërtimi i vendit të punës _____
Name of the job position

2. TË DHËNAT E TË HUAJIT / INFORMATION ABOUT THE FOREIGNER

1. Mbiemri _____
Surname2. Emri _____
Given name(s)3. Emri i babait _____
Name of the parent4. Datëlindja /___/___/___/___/___/___/___/___/
Date of birth5. Gjinia **F M** /___/___/___/___/___/___/___/___/
Sex **M F*** to be entered if issued6. Vendi dhe shteti i lindjes _____
Place and country of birth7. Shtetësia _____
Nationality



8. Adresa e banimit në Shqipëri _____
Residential address in the Republic of Albania

9. Kodi dhe emri i punësimit / ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ _____
Code and name of occupation

10. Kualifikimet / ____/ ____/ ____/
Skills qualifications

11. Aktivitet fitimprurës **PO JO**
Gainfully employed/activity **YES NO**

3. DOKUMENT I VLEFSHËM / VALID DOCUMENT

1. Lloji i dokumentit _____
Type of document

2. Numri / ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/
Number

3. Lëshuar në / ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/
Issued on

4. E vlefshme deri më / ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/ ____/
Valid until

5. Autoriteti kompetent _____
Competent authority

6. Lëshuar nga _____
Place and country of issuance

Vendi dhe data
(Place and date)

Emri / mbiemri i aplikantit
(Applicant)

VENDIM Nr. 385, datë 27.6.2018

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 285, DATË 13.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘HIDROCENTRALI I BANJËS–GRAMSH DHE URA E TRASHOVICËS’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936,

datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 285, datë 13.4.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat si më poshtë vijon:

1. Pas tabelës së përmendur në pikën 3 shtohet tabela nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1 Vlerës totale të shpronësimit i shtohet shuma prej 251 516 (dyqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh për pasurinë e llojit “drufrutorë.”.



3. Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, si më poshtë vijon:

“4.1 Vlera e shpronësimit të pronarit, sipas këtij vendimi, në shumën prej 251 516 (dyqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a.”.

4. Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1 Vlerës totale të shpenzimeve procedurale i shtohet shuma 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila do të përballohet nga buxheti i shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

Tabela nr. 2

LISTA E PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “HIDROCENTRALI I BANJËS-GRAMSH DHE URA E TRASHOVICËS”, “PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 285, DATË 13.4.2016”

Nr.	Emër, atësia mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Vlera e kulturave bujqësore (drufrutore)	Vlera totale	Dokumenti i pronësisë
1	Nderim Skender Duzha	3103	101/3	Pemëtore	251 516	251 516	Konfirmuar nga ZVRPP-ja (diferencë vlere, pemë drufrutore)
	TOTALI					251,516	

VENDIM

Nr. 386, datë 27.6.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 37, DATË 18.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 kV GJIRI I LALËZIT, DURRËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 37, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Tabela e përmendur në pikën 1 zëvendësohet me tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në pikën 3, vlera e përgjithshme e shpronësimit zëvendësohet me 1 296 602 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dy) lekë.

3. Në pikën 4, vlera e përgjithshme e shpronësimit zëvendësohet me 1 296 602 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dy) lekë.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, si më poshtë vijon:

“4.1 Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.”.

5. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Shpronësimi të fillojë menjëherë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 KV, GJIRI I LALËZIT”, DURRËS, FSHATI KURATEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM

Investitori: OSHEE sh.a.

Çmimi për pasurinë truall sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Shtet	2332	242/1	PF	m ²	234			Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Thoma Çuni	2332	242/2	Arë	m ²	3266	397	1,296,602	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Shuma totale e shpronësimit: 1,296,602									

VENDIM

Nr. 387, datë 27.6.2018

PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR “PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, FINANCIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E SEGMENTIT RRUGOR MILOT-BALLDREN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, në vijim të nenit 15, të rregullave për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale, miratuar me vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 8,5% (tetë presje pesë për qind) të pikëve, që i jepet shoqërisë “A.N.K.” sh.p.k., për rezultatin teknik dhe financiar të propozimit të pakërkuar, të paraqitur për procedurën për dhënie me koncesion/partneritet publik privat për “Projektimin, ndërtimin, financimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot-Balldren”.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 389, datë 27.6.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 452, DATË 11.7.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LENDFILLET E MBETJEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 43, pikat 6 e 7, 44, pika 3, 45 e 64, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 25, 26, 28 dhe 29, në kreun XI, ndryshohen si më poshtë vijon:

“25. Operatori i një venddepozitimi ekzistues, pavarësisht nëse ka ose jo leje mjedisi, deri në datën 31 dhjetor 2018 përgatit një plan përmirësimi të venddepozitimit dhe e paraqet atë për miratim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

26. Plani i përmirësimit, sipas përcaktimit të pikës 25, të këtij kreu, përfshin kërkesat e përcaktuara në pikën 6, të kapitullit VI, të këtij vendimi, dhe masat konkrete të përcaktuara në aneksin I/I, bashkëlidhur këtij vendimi.



...

28. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit, e dërgon atë për shqyrtim në Komitetin Ndërmimiror për Mbetjet, i cili vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre. Kjo periudhë, në çdo rast, përfundon në datën 31 dhjetor 2020.

29. Plani i përmirësimit i miratuar, masat e nevojshme dhe periudha e tranzicionit, e referuar në pikën 28, të këtij vendimi, përbëjnë një pjesë të lejes së mjedisit për atë venddepozitim ekzistues. Subjekti paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për dorëzimin e planit. Në rastin kur subjekti është i pajisur me planin e përmirësimit përpara se të pajiset me leje mjedisi, atëherë, në momentin e aplikimit pranë QKB-së ai do të paraqesë këtë plan si dokument më vete, i cili do t'i përcillet në mënyrë elektronike Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, së bashku me dokumentet e tjera aplikuese.”.

b) Shkronja “b”, e pikës 31, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) Nuk arrin të pajiset me leje mjedisi, sipas dispozitave të këtij vendimi.”.

c) Pika 32 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“32. Operatori i vendit të venddepozitimit ekzistues, sipas dispozitave të këtij kreu, përjashtohet nga detyrimi për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në aneksin I, të këtij vendimi, deri në datën 31 dhjetor 2030. Në çdo rast, ndalohet të depozitohen apo trajtohen mbetjet e ngurta në një venddepozitim ekzistues kur në atë zonë mbetjesh funksionon një impiant rajonal për trajtimin e mbetjeve, i cili plotëson standardet mjedisore dhe teknike.”.

ç) Pas aneksit I shtohet aneksi I/I, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

ANEKSI I/I

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR VENDDEPOZITIMET EKZISTUESE

KRITERET E VLERËSIMIT DHE KLASIFIKIMIT

Mbrojtja e ujit			
Ndotja e ujërave sipërfaqësore	Distanca nga lumi ose në breg të lumit (nëse uji përdoret vetëm për bujqësi)	Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 (e ndaluar) Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë Më shumë se 300 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 2.1 Grumbullimi i ujit me kullim periferik 2.2 Drenimi dhe grumbullimi i ujërave dhe gazit që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) 2.3 Menaxhimi i ujërave rrjedhëse 2.4 Zbatimi i ruajtjes dhe riqarkullimit të gazit dhe ujit që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) 2.5 Zbatimi i përpunimit të gazit dhe ujërave që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) 3.2 Ndërtimi i pengesave mbrojtëse/stabilizuese 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së venddepozitimit
			1.1 Largimi i mbetjeve 2.1 Grumbullimi i ujit me kullim periferik 2.3 Menaxhimi i ujërave rrjedhëse 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së venddepozitimit
Ndotja e ujërave sipërfaqësore	Distanca nga bregdeti	Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 (e ndaluar) Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë Më shumë se 300 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 2.1 Grumbullimi i ujit me kullim periferik
Ndotja e ujërave sipërfaqësore	Distanca nga bregu i liqenit (nëse uji përdoret vetëm për bujqësi)	Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 (e ndaluar) Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 2.1 Grumbullimi i ujit me kullim periferik



		Më shumë se 300 m: 5 pikë	2.2 Drenimi dhe grumbullimi i gazit dhe ujërave që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) 2.3 Menaxhimi i ujërave rrjedhëse 2.4 Zbatimi i ruajtjes dhe riqarkullimit të gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>) 2.5 Zbatimi i përpunimit të gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>) 3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së venddepozitimit
Ndotja e ujit të pijshëm	Rrjedha e sipërme e një burimi të përdorur të ujit të pijshëm (ujë sipërfaqësor ose nëntokësor) ose në një zonë të mbrojtur për ujin e pijshëm (zona e menjëhershme e mbulimit)	Ndërmjet 0 dhe 300 m: 0 (e ndaluar) Ndërmjet 300 dhe 800 m: 3 pikë Më shumë se 800 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 2.1 Grumbullimi i ujit me kullim periferik 3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së venddepozitimit
Mbrojtja e ujit/mbrojtja e popullatës	Në një zonë ku mund të ndodhin përmytje	Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 pikë Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë Më shumë se 300 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 2.1 Grumbullimi i ujit me kullim periferik 3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim
Mbrojtja e ujit/mbrojtja e nëntokës	Gjeologjia e zonës së treguar	Përshkueshmëri e lartë e nëntokës: 0 pikë Përshkueshmëri mesatare e nëntokës: 3 pikë Përshkueshmëri e ulët: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 2.1 Grumbullimi i mbetjeve me kullim periferik 2.2 Drenimi dhe grumbullimi i gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>)
Mbrojtja e popullatës dhe shqetësimi			
Mbrojtja e popullatës/operatorit	Në një zonë të paqëndrueshme (risiku i rrëshqitjeve të tokës)	Mbetjet e asgjësuar ose venddepozitimit e mbetjeve paraqesin një risk të konfirmuar kolapsi: 0 pikë Mbetjet dhe venddepozitimet e mbetjeve janë në një zonë potenciale për rrëshqitje toke: 3 pikë Mbetjet e asgjësuar apo venddepozitimet e mbetjeve janë të qëndrueshme dhe nuk ka risk kolapsi apo rrëshqitje toke: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 3.1 Ndërtimi i digave për stabilitetin e mbetjeve 3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim 4.1 Zbatimi i sistemit të evakuimit të gazit
Ekspozimi i njerëzve ndaj ndotjes potenciale	Zona të afërta të banuara legalisht	Ndërmjet 0 dhe 100 m: 0 pikë Ndërmjet 100 dhe 300 m: 3 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/



		Më shumë se 300 m: 5 pikë	stabilizim 4.1 Zbatimi i sistemit për evakuimin e gazit
Prania potenciale e mbetjeve të rrezikshme, risku për operatorin e venddepozitimit, banorët në afërsi dhe mjedisin	Mbetje industriale apo jourbane të pranishme në mbetjet hyrëse.	Prania e mbetjeve industriale të rrezikshme: 0 pikë Prania e mbetjeve industriale inerte: 3 pikë Prania e mbetjeve urbane: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 3.2 Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim 4.1 Zbatimi i sistemit të evakuimit të gazit
Mbrojtja mjedisore dhe vlera turistike			
Degradimi i peizazhit, rënia e vlerës turistike	Në vende të dukshme nga vendet turistike	Po: 0 pikë Jo: 1 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së venddepozitimit
Vende arkeologjike, zona të trashëgimisë kulturore dhe zona të tjera të mbrojtura të përcaktuara si të tilla me VKM (vendim të Këshillit të Ministrave)	Distanca nga zonat e mbrojtura zyrtarisht	Ndërmjet 0 dhe 300 m: 0 (e ndaluar) Ndërmjet 300 dhe 800 m: 3 pikë Më shumë se 800 m: 5 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së venddepozitimit
Ndotja e florës dhe faunës, ndikimi mbi turizmin	Në një zonë natyrore të mbrojtur (rezervuar natyror, park kombëtar etj.)	Po: 0 pikë Jo: 1 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 2.2 Drenimi dhe grumbullimi i gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>) 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së venddepozitimit
Zjarri në pyje, ndotja e florës dhe faunës	Në një pyll (distanca ndërmjet venddepozitimit dhe pyllit duhet të jetë më shumë se 10 m për të shmangur zjarret)	Po: 0 pikë Jo: 1 pikë	1.1 Largimi i mbetjeve 1.2 Zhvendosja e mbetjeve 1.3 Ndërtimi i një gardhi 1.4 Prerja e pyjeve dhe shkurreve, sigurimi kundër zjarreve 4.1 Zbatimi i sistemit të evakuimit të gazit 5.1 Zbatimi i mbulimit final dhe mbylljes së venddepozitimit
Kriteret e operimit			
Venddepozitimi i mbetjeve do të mbushet shumë shpejt dhe si rrjedhim nuk është e qëndrueshme	Volumi i shfrytëzimit përfaqëson një kapacitet prej më pak se 1 vit operimi ⁵	Disponueshmëria e mbetjeve < 1 vit: 0 pikë Disponueshmëria e mbetjeve < 2 vjet: 1 pikë Disponueshmëria e mbetjeve < 5 vjet: 3 pikë Disponueshmëria e mbetjeve > 5 vjet: 5 pikë	3.1 Ndërtimi i digave për stabilitet të mbetjeve

⁵ Duke marrë në konsideratë të gjitha punimet e mundshme përmirësuese për të rritur volumin dhe kapacitetin (zgjerimin e sipërfaqes, ngritjen, gjeometrinë etj.).



METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE E KLASIFIKIMIT

Sa më i lartë rezultati aq më shumë prioritet do t'i jepet këtij venddepozitimit të mbetjeve. Venddepozitimet e kategorizuara në kategoritë C dhe D nuk do të lejohen të operojnë.

Klasifikimi final është bërë siç tregohet në shembullin e mëposhtëm.

Klasifikimi	Venddepozitimi i mbetjeve	Rezultati total	Distanca e transportit në venddepozitimin tjetër të qarkut > 2 orë	Venddepozitimi gjendet në bregdet apo në një zonë me prioritet të lartë turistik
1	Venddepozitimi A	18		
2	Venddepozitimi B	11		
3	Venddepozitimi C	10		
4	Venddepozitimi D	8		

KRITERET E PËRJASHTIMIT

Pavarësisht nga rezultati i vlerësimit sipas pikës 1 të këtij aneksi dhe metodologjisë së vlerësimit në pikën 2 të këtij aneksi, venddepozitimi do të lejohet ose jo të operojë sipas përcaktimit të dy kriterëve të përjashtimit:

Distanca ndërmjet venddepozitimit: në një qark, nëse dy venddepozitime mbetjesh gjenden më shumë se 2 orë distancë udhëtimi nga njëra-tjetra, mund të merret në konsideratë lënia hapur e të dyja venddepozitimeve të mbetjeve, për arsye operationale. Nga ana tjetër, nëse venddepozitimet janë afër njëra-tjetrës, duhet të vihet në funksionim vetëm ajo me rezultatin më të lartë të vlerësimit.

Vlera turistike: vendosja e një venddepozitimi mbetjesh në një vend turistik apo në zona të mbrojtjes natyrore sipas legjislacionit në fuqi, është e ndaluar.

Tabela model e vlerësimit të kriterëve përjashtuese.

Klasifikimi	Venddepozitimi i mbetjeve	Rezultati total	Distanca e transportit për në venddepozitimet e tjera të mbetjeve në qark > 2 orë	Venddepozitimi gjendet në breg të detit ose në zona me prioritet të lartë turistik
1	Venddepozitimi A	18	A deri në B: 3 orë A deri në C: 0.5 orë A deri në D: 4 orë	Jo
2	Venddepozitimi B	11	B deri në A: 3 orë B deri në C: 2 orë B deri në D: 2.5 orë	Po
3	Venddepozitimi C	10	C deri në A: 0.5 orë C deri në B: 2 orë C deri në D: 3.5 orë	Jo
4	Venddepozitimi D	8	D deri në A: 4 orë D deri në B: 2.5 orë D deri në C: 3.5 orë	Jo

Metodologjia e vlerësimit

Në tabelën model të vlerësimit të kriterëve përjashtuese, venddepozitimi C do të përjashtohet për shkak të afërsisë me një venddepozitim “më të mirë” (venddepozitimi A). Venddepozitimi B do të përjashtohet për shkak të vendndodhjes së saj në një zonë me aktivitet të lartë turistik.

Organi i vetë-qeverisjes vendore mund të vendosë për vazhdimin e funksionimit të venddepozitimit A dhe venddepozitimit D, megjithëse kjo e fundit ka vlerësim më të ulët, për shkak të distancës së madhe ndërmjet dy venddepozitimeve D.

KATALOGU I MASAVE

Masat që merren për operimin e venddepozitimit janë:

MASAT E PËRPIKTA
Largimi i mbetjeve
Zhvendosja e mbetjeve
Ndërtimi i një gardhi



Prekje e pyjeve dhe shkurreve, si siguri kundrejt zjarreve
MASAT E MENAXHIMIT TË UJIT
Mbledhja e ujit me kullim periferik
Drenimi dhe grumbullimi i gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>)
Menaxhimi i ujërave rrjedhëse
Zbatimi i ruajtjes dhe riqarkullimit të gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>)
Zbatimi i përpunimit të gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>)
MASAT E STABILIZIMIT DHE E MBROJTJES
Ndërtimi i digave për stabilitetin e mbetjeve
Ndërtimi i pengesave për mbrojtje/stabilizim
MENAXHIMI I GAZIT
Zbatimi i sistemit për evakuimin e gazit
MASAT E MBYLLJES
Zbatimi i mbulimit final dhe mbyllja e venddepozitimit

Metodologjia e zbatimit të masave

Pasi të jenë identifikuar venddepozitimet, të cilat do të mbahen në funksionim, duhet të zbatohen masat teknike në venddepozitim me qëllim që të përmirësohet situata dhe për të kufizuar ndikimin e tyre në mjedis.



Lidhur me vendimin për zgjedhjen e masave që janë të përshtatshme për t'u zbatuar, tabela e vlerësimit tregon masat përkatëse që duhet të zbatohen për çdo kriter. Grupi i punës si rrjedhim mund të hartojë një listë masash për çdo venddepozitim dhe të organizojë punimet. Masat fizike do të zbatohen edhe për venddepozitimet që do të mbyllen (shiko masat për mbylljen).

Të gjitha masat mund të përcaktohen si “praktika të mira”, prandaj asnjë masë nuk duhet të ketë ndikim negativ, nëse aplikohet me korrektësi. Edhe nëse rezultati i vendosur është 0 pikë, mund të merret në konsideratë zbatimi i masave teknike, megjithëse ato nuk mund të përbëjnë kriterin bazë të vlerësimit.

PËRSHKRIMI I MASAVE DHE MËNYRA E ZBATIMIT TË TYRE

LARGIMI I MBETJEVE	Synimet: Largimi i materialit të mbetjeve të cilat mund të krijojnë një ndikim të caktuar (rrezik apo dëm); Evitimi që mbetjet të mos shihen në zonat turistike; Evitimi që mbetjet të mos largohen nga era/uji etj.	Risqet: Ndotja e burimeve natyrore; Ndikim negativ në turizëm; Mbetjet që përhapen jashtë kufijve të venddepozitimit; Risku që lidhet me rrëshqitjet e tokës (kolapsi i mbetjeve).
Përshkrimi	Në rastet kur ka ndikim real në objektivat e ndjeshëm që janë vendosur (p.sh., burimet ujore, popullata etj.) mbetjet duhet të largohen dhe transportohen në një venddepozitim tjetër. Para se mbetjet të largohen duhet të identifikohet më parë venddepozitimi i destinuar dhe të miratohet nga autoritetet lokale. Me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, kur mbetjet asgjësohen në venddepozitime që nuk janë të rregulluara ose kur venddepozitimi do të ndalohet të përdoret. Largimi i mbetjeve do të ekzekutohet me një ekskavator dhe transportimi me një kamion të mbyllur. Në të gjitha rastet, duhet të shmangët kontakti i stafit me mbetjet (të evitohet prekja), pasi përmbajtja e tyre është e paditur dhe mund të jenë të pranishme materiale të rrezikshme edhe brenda mbetjeve të ngurta urbane. Pasi hidhen, mbetjet do të ngjeshen dhe më pas do të mbulohen me dhé. Pjerrësia nuk duhet të jetë më e madhe se 3 horizontale për 2 vertikale. Popullsia duhet të informohet për këtë veprim. Ky operacion mund të gjenerojë erë të keqe dhe zjarre. Pas largimit të mbetjeve, toka mbulohet me dhé dhe material i gërmuar nga toka, me qëllim që të pushtohet nga vegetacioni. Kjo do ta stabilizonte tokën dhe do të ndalonte erozionin. Paralajmërim: ky operacion duhet të ekzekutohet në kushte të sigurta dhe procedura të kontrolluara. Prania e mbetjeve të rrezikshme, stabiliteti i mbetjeve dhe çlirimi i gazeve mund të vërë në rrezik operatorin. Punimet do të planifikohen nga specialistët e sektorit.	




Planet/figurat/ shembujt		Shembull. Ky është rasti kur mbetjet asgjësohen në venddepozitime që prekin apo janë afër një burimi uji të pijshëm (puse publike apo private). Mbetjet duhet të transportohen në një vend më të sigurt. Nëse kjo nuk është e mundur, burimi i ujit për popullatën duhet të zëvendësohet me një burim më të sigurt, mundësisht të lidhur me një rrjet të ujit të pijshëm.
ZHVENDOSJA E MBETJEVE	Objektivat: Evitimi që mbetjet të shihen në zonat turistike; Evitimi që mbetjet të lëvizin nga era/uji etj.; Zvogëlimi i materialeve të mbetjeve të cilat mund të krijojnë një ndikim të caktuar (rrëshqitjet e tokës, ndikim vizual etj.)	Risqet: Ndikim negativ në turizëm; Mbetjet që përhapen jashtë kufijve të venddepozitimit; Risku që lidhet me rrëshqitjet e tokës.
Përshkrimi	Në rastin e një ndikimi real, mbetjet mund të largohen në një pjesë tjetër të venddepozitimit (masë mbrojtjeje). Largimi do të ekzekutohet me një ekskavator dhe transportimi me një makinë hedhëse ose kamion. Në të gjitha rastet, duhet të shmanget kontakti i stafit me mbetjet (p.sh., preken), pasi përmbajtja e tyre është e panjohur dhe materialet e rrezikshme mund të jenë të pranishme dhe brenda mbetjeve të ngurta urbane. Operacioni mund të gjenerojë erë të keqe dhe zjarre. Nëse masa merret për shkak të afërsisë me një lum, mund të merret në konsideratë rinforsimi i shtratit të lumit ose të mbrohet ndërlidhja mes shtratit të lumit dhe mbetjeve (shiko masën “Ndërtimi i pengesave mbrojtëse”). Paralajmërimi: ky operacion duhet të ekzekutohet në kushte të sigurta dhe procedura të kontrolluara. Prania e mbetjeve të rrezikshme, stabiliteti i mbetjeve dhe çlirimi i gazeve mund të vërë në rrezik operatorin. Punimet duhet të planifikohen nga specialistët e sektorit. Zona ku janë larguar mbetjet duhet të shënjohet me qëllim që të shmanget hedhja e mbetjeve të reja në të njëjtin vend.	
Plane/figura/shembuj	Ky është rasti kur mbetjet hidhen në venddepozitim që nuk kanë stabilitet, që janë afër shtretërve të lumenjve ose burimeve ujore në afërsi të tyre (puse private).	
NDËRTIMI I NJË GARDHI	Objektivat: Krijimi i një pengese ndërmjet popullatës/kafshëve dhe mbetjeve; Shmangja që mbetjet të largohen nga era/uji etj.; Kufizimi i kufijve të venddepozitimit.	Risqet: Rrezik për shëndetin e popullsisë dhe kafshëve; Mbetje që përhapen jashtë kufijve të vend-depozitimit.
Përshkrimi	I gjithë perimetri i venddepozitimit duhet të rrethohet me gardh për të shmangur hyrjen e paligjshme në venddepozitim. Mund të merrni në konsideratë ndërtimin e një gardhi me tela hekuri (me një lartësi prej 2–3 m) me shtylla betoni dhe një portë për të lejuar dhe kontrolluar hyrjen e kamionëve dhe njerëzve. Kamionët që transportojnë mbajtjet duhet të kenë hapësirën e duhur për të lëvizur brenda venddepozitimit, brenda gardhit të vendosur, në mënyrë që nëse derdhen mbetje gjatë lëvizjes, ato të mund të mbeten brenda kufijve të venddepozitimit. Në rast se në atë vend ka erëra të forta, gardhi nga ana e drejtimit të erës duhet të jetë më i lartë për të shmangur përhapjen e mbetjeve jashtë venddepozitimit (kjo duhet të merret në konsideratë në mënyrë të veçantë kur venddepozitimi është afër shtëpive apo zonave turistike). Për këtë qëllim, kjo pjesë e gardhit mund të projektohet si një sistem i lëvizshëm me qëllim që të lëvizet sipas ngritjes që do të pësojë vendhedhja.	
Plane/figura → gardhi, rruga e hyrjes		








PRERJA E PYJEVE DHE SHKURREVE	Objektivat: Heqja e materialeve të djegshme që ndodhen mes venddepozitimit dhe pyllit më të afërt; Të lejohet lëvizja e duhur brenda venddepozitimit.	Risqet: Zjarret në pyje si rrjedhim i zjarrit në venddepozitim.
Përshkrimi	Rreziku i zjarrit në venddepozitim është shumë i lartë. Origjina e zjarrit mund të jetë natyrale apo nga aktivitetet njerëzore. Në çdo rast duhet të shmangni përhapjen e këtyre zjarreve në pyjet më të afërta. Prania e pemëve në venddepozitim përbën material të djegshëm që paraqet një rrezik serioz në rast se mbetjet marrin zjarr. Për të zvogëluar rrezikun e përhapjes së zjarrit që mund të marrin mbetjet deri te pylli më i afërt atëherë brenda venddepozitimit apo rrotull kufijve të saj nuk duhet të ketë pemë, shkurre apo rrënjë. Nevojitet të mbahet një distancë minimale prej 10 m ndërmjet venddepozitimit dhe pyllit më të afërt dhe duhet të mos ketë pemë dhe materiale të djegshme. Kjo masë duhet të përsëritet një herë në vit, preferohet në fillim të sezonit veror. Një pìrg me dhë duhet të përgatitet afër venddepozitimit që do të shërbejë për shuarjen e zjarrit, me qëllim që të mbulohen mbetjet në rastet kur marrin zjarr.	

MBLEDHJA E UJËRAVE SIPËRFAQËSORE DHE KULLIMI PERIFERIK	Objektivat: Minimizimi i prodhimit të ujit të ndotur; Minimizimi i ujit të shiut që hyn te mbetjet; Devijimi i ujit të shiut dhe ujërave rrjedhëse.	Risqe: Ndotja e ujit; Kolapsi / destabilizimi i mbetjeve; Përmbytja e venddepozitimit.
Përshkrimi	Kullimi periferik vendoset në kufirin e venddepozitimit, për të ndalur ujin që vjen nga zona fqinje dhe ujërat që rrjedhin nga venddepozitimi (uji i shiut që nuk infiltrohet te mbetjet). Meqenëse ky ujë nuk infiltrohet te mbetjet ai konsiderohet si jo i ndotur dhe mund të orientohet drejt lumit më të afërt. Reduktimi i ujit që hyn te mbetjet dhe prodhimi i ujit nga mbetjet është një objektiv i rëndësishëm afatgjatë. Sipërfaqja e mbetjeve duhet të jetë e pjerrët, për të nxitur rrjedhën e ujit të shiut dhe për të shmangur krijimin e pellgjeve të përkohshme të cilat mund të destabilizojnë mbetjet dhe të pengojnë funksionimin e duhur të përditshëm të makinerive. Për të ulur volumin e ujit në venddepozitim, sipërfaqja e punës e mbetjeve të pambuluara duhet të jetë minimale. Struktura e venddepozitimit A duhet të ndalohet dhe struktura B duhet të zbatohet. Reshjet e shumta të Shqipërisë detyrojnë venddepozitimet që të jenë të pajisura me një sistem për mbledhjen e ujit nga sipërfaqja e venddepozitimit, për të shmangur erozionin e mbetjeve. Sipërfaqja e mbetjeve duhet të organizohet në “hapa”, për çdo 5 m ngritje, për të qenë të aftë të instalohen kanale kulluese sipërfaqësore në çdo nivel. Kjo bëhet duke modeluar sipërfaqen e venddepozitimit. Ky drenim sipërfaqësor mund të ndërtohet me gjysmëtuba ose me zgjidhje të ngjashme me këtë (beton). Kanalet kulluese drejtojnë ujërat sipërfaqësore drejt një “ujëvare”, e cila garanton lidhjen e kanaleve kulluese sipërfaqësore me kanalet kulluese periferike (shiko masën 2.3), duke shpërndarë energjinë ujore dhe duke parandaluar erozionin. Përmasat e kanaleve kulluese periferike duhet të përshtaten në varësi të të dhënave për reshjet dhe gjeometrinë lokale. Kanalet kulluese periferike janë të ngjashme me sistemin anësor kullues të rrugëve. Megjithatë ai mund të ndërtohet në mënyra të ndryshme, sipas strukturës së dheut në zonë: gërmime në tokë të mbuluar me gurë, elemente çimentoje të parafabrikuar, gjysmëtubash plastikë etj. Faktori i rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë është kontrolli i stabilitetit dhe erozionit të sistemit gjatë shirave të rrëmbyeshme dhe mundësia për të pastruar dhe mirëmbajtur kanalet kulluese (d.m.th., shmangni tubat e mbyllur pasi mund të ketë dhe bllokime). Një pjerrësi prej 0.5% konsiderohet e mjaftueshme. Dalja e kanaleve kulluese periferike drejt lumit ka nevojë të forcohet për të shpërndarë energji, shmangur erozionin dhe kolapsin e strukturës (shiko masën “menaxhimi i ujërave rrjedhëse”). Vini re: Infiltrimi i ujit te mbetjet dhe grumbullimi i tij në fund të venddepozitimit gjeneron gaz dhe ujëra nga kullimi (<i>leachate</i>) dhe mund të destabilizojë masën dhe të përbëjë një risk të madh për operatorët dhe mjedisin. Duke kapur ujërat rrjedhëse sipërfaqësore para se të infiltrohen te mbetjet, sasia e ujit të ndotur (gazit dhe ujërave nga kullimi: <i>leachate</i>) ulet, si risk destabilizimi.	

Plane/figura/ shembuj	 Figura 1. Lidhja e prodhimit të gazit dhe ujit nga kullimi (<i>leachate</i>) me sipërfaqen e venddepozitimit, strukturën dhe elementet e sistemit të kullimit.
--------------------------	--

DRENIMI DHE GRUMBULLIMI I GAZIT DHE UJËRAVE NGA KULLIMI (<i>LEACHATE</i>)	Objektivat: Minimizimi i ujit që kalon nëpër mbetje; Shmangia e ujit që grumbullohet brenda venddepozitimit me qëllim që të reduktojë riskun e rrëshqitjes nga toka. Risqet: Ndotja e ujit; Kolapsi/destabilizimi i mbetjeve, rrëshqitjet e tokës.
Përshkrimi	Uji që kalon përmes masës së mbetjeve ekziston si ujë i ndotur (gaz dhe ujërat nga kullimi: <i>leachate</i>), i cili duhet të mbledhet dhe përpunohet. Nëse nuk bëhet kështu, përveç ndotjes, grumbullimi i ujit në fund të venddepozitimit mund të destabilizojë masën e mbetjeve dhe përbën një risk të madh për operatorët dhe mjedisin. Në venddepozitimin ekzistues kullimi i gazit dhe i ujërave që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>) mund të bëhet duke sheshuar dhe ngjeshur sipërfaqen e punës (duke krijuar një pjerrësi prej 5–6%) dhe duke instaluar një shtresë për kullimin, mbi të cilën do të hidhen mbetjet në të ardhmen. Në këtë mënyrë, uji rrjedh përmes mbetjeve deri sa të arrijë shtresën e kullimit e cila devijon ujin drejt pikës më të ulët. Kullimi përbëhet nga dy lloje elementesh: Linjat e brendshme të kullimit janë linja materiali të ndara me 10 deri në 15 metra (në varësi të reshjeve vjetore). Volumi i linjës së kullimit është 1 m³ e materialit për metër linear. Materiali i përdorur për ndërtimin e “linjave të drenimit” brenda kufijve të venddepozitimit përbëhet nga zhavorr apo gurë ose mbetje materiale ndërtimi të përzgjedhura më mirë (tulla, gurë, beton i thyer etj.). Diametri i elementeve duhet të jetë ndërmjet 3 mm dhe 15 mm; Tubi i kanalit kullues të jashtëm (diametri i brendshëm afërsisht 15 cm) në kufijtë e venddepozitimit, i cili mbledh gazin dhe ujin nga kullimet (<i>leachate</i>) e bëra nga linjat e zhavorrit. Dalja (pika më e ulët) e kullimit periferik lidhet me sistemin e ulluqeve ose me një sistem për përpunimin e ujit (shiko masën 2.4 dhe 2.5). E rëndësishme: Nuk duhet të përdoren materiale me një diametër prej më pak se 3 mm për material drenimi dhe fletët plastike apo të letërës duhet të largohen. Këta dy faktorë mund të shkaktojnë bllokimin e sistemit dhe mos realizimin e drenimit. Për ta zbatuar atë: kullojini materialet me një “rrjetë metalike” (që përdoret për gardhet e pulave); Ndërmjet linjave të materialeve të drenimit, mund të hidhen mbetjet deri sa të mbushet e gjithë shtresa. Operatorët duhet t’i kushtojnë vëmendje që të mos shkatërrohen linjat e drenimit gjatë hedhjes së mbetjeve; Numri i saktë i kanaleve kulluese që nevojiten do të llogaritet sipas të dhënave për reshjet lokale; Shtresa e kullimit duhet të vendoset mbi një sipërfaqe me mbetje të ngjeshura. Sa herë që keni mundësi, bëni ngjeshjen duke përdorur automjete apo makineri të rënda para se ta instaloni atë. Kjo vlen edhe për shtresën më të ulët të venddepozitimeve të reja që do të rregullohen si venddepozitime të rregulluara.

Plane/figura/ shembuj		
ose	 1m³/m¹ OR 	
→ Dalja e gazit dhe e ujërave nga kullimi edhe pa sistem drenazhi	 Figura 2. Në foton sipër: forma e linjës së drenimit të gazit dhe e ujit nga kullimi, e ndërtuar mbi sipërfaqen e ngjeshur apo në të. Majtas: me të zeza tregohet drenimi periferik; me të kuqe janë linjat e drenimit të gazit dhe të ujit nga kullimi. Këto linja janë poshtë sipërfaqes së mbetjeve dhe mbledhin lëngjet që rrjedhin përmes mbetjeve për t'i drejtuar ato drejt përpunimit adekuat të tyre.	Figura 3. Për të drenuar venddepozitimin, sipërfaqja ku do të vendosen mbetjet duhet të ketë një pjerrësi minimalisht prej 5% në drejtim të pikës së daljes. Këshillohet një pjerrësi prej 10%, kur mbetjet janë të trasha dhe pritët të bëhet dhe ngjeshja e mbetjeve. Sipërfaqja duhet të jetë e ngjeshur, duke krijuar një shtresë kundër ujit” (që paraqitet në vizatim me ngjyrën e kuqe të errët) për të kufizuar në maksimum infiltrimin e gazit dhe ujërave nga kullimi (<i>leachate</i>) në nëntokë (shigjetat e vogla ngjyrë rozë). Shtresa ngjyrë portokalli tregon ku janë vendosur linjat e drenimit për të kapur gazin dhe ujërat nga kullimi (<i>leachate</i>) dhe për t'i drejtuar drejt tubit të jashtëm të drenimit.
	 leachate outlet even without drainage system Figura 4. Uji që rrjedh përmes mbetjeve duhet të konsiderohet si gazi dhe ujërat që dalin nga kullimi (<i>leachate</i>). Këto gjenerohen edhe në mungesë të sistemit të drenazhit.	

MENAXHIMI I UJËRAVE RRJEDHËSE	Objektivat: Minimizimi i ndikimit të erozionit nga uji i shiut; Shmangni që uji të hyjë dhe të grumbullohet brenda venddepozitimit.	Risqet: Kolapsi/destabilizimi i mbetjeve.
Përshkrimi	Reshjet e shumta të Shqipërisë detyrojnë venddepozitimet që të kenë një sistem për mbledhjen e ujit të shiut nga sipërfaqja e venddepozitimit për të shmangur erozionin e mbetjeve. Kjo realizohet duke modeluar sipërfaqen e mbetjeve për të arritur të “hapat” ku mund të arrihet në ndërtimin e drenimit të sipërfaqes (shiko masën 2.1). Lidhja mes drenimit të sipërfaqes dhe drenimit periferik është një “ujëvarë” që ka dy funksione: të kanalizojë ujin dhe të shpërndajë energjinë e tij. Lidhja mes kanaleve kulluese të sipërfaqes së vendosur në nivele të ndryshme të	



	venddepozitimit mund të realizohet me kanalet e elementeve të mbivendosura prej betoni, të vendosura në sipërfaqen e mbetjeve dhe duke arritur në drenimin e jashtëm me një strukturë të përforcuar (p.sh. gurë të thyer apo bazën betoni). Më pas, uji i mbledhur drejtohet drejt daljes, që duhet të jetë një lum apo liqen. Duhet të ndërtohet një strukturë me gurë të thyer që të mbrojë pikën e daljes nga erozioni (p.sh., basen i qëndrueshëm i mbushur me zhavorr të trashë).
Plane/figura	


ZBATIMI I RUAJTJES DHE I RIQARKULLIMIT TË GAZIT DHE TË UJIT QË DEL NGA KULLMI (LEACHATE)	Objektivat: Të kufizohet çlirimi i gazit dhe ujërave nga kullimi.	Risqet që lidhen me këtë: Ndotja e ujërave sipërfaqësore; Ndotja e ujërave nëntokësore.
	Gazi dhe ujërat që dalin nga kullimi janë lëngjet mbetje që vijnë nga filtrimi i ujit përmes një materiali, një fraksion i të cilit mund të jetë i tretshëm, në këtë rast mbetjet. Ndotja që pritet nga një venddepozitim mbetjesh lokale, e caktuar nga bashkia, është kryesisht organike. Për një venddepozitim konsiderohet që 60% e ujit të shiut kalon nëpër mbetjet dhe bëhet <i>leachate</i>: gaz dhe ujë që del nga kullimi. Për një venddepozitim të mbuluar me materiale inerte, rrjedhja është më e lartë dhe si rezultat gazit dhe ujit që del nga kullimi (<i>leachate</i>) do të jetë rreth 40% e ujit të shiut. Për një venddepozitim të rregulluar me pjerrësi minimalisht prej 5-10%, drenimi sipërfaqësor dhe i mbuluar me materiale inerte, gazit dhe ujërat nga kullimi (<i>leachate</i>) mund të llogariten deri në 20% të reshjeve vjetore. Reshjet e dendura rrisin sasinë e (<i>leachate</i>) gazit dhe të ujit nga kullimi. Në varësi të përbërjes së mbetjeve në venddepozitimin e mbetjeve dhe të sasisë së shiut, karakteristikat e (<i>leachate</i>) gazit dhe të ujit nga kullimi do të jenë të ndryshme. Gazi dhe uji nga kullimi (<i>leachates</i>) duhet të mblidhen dhe përpunohen. Për të ulur volumin që do të përpunohet, zbatohet riqarkullimi i (<i>leachates</i>) gazit dhe i ujit nga kullimi, nëpër masën e mbetjeve. Për të realizuar këtë, duhet të ndërtohet një rezervuar për të mbledhur (<i>leachates</i>) gazin dhe ujin nga kullimi, në dalje të sistemit të jashtëm të drenimit (shiko masën “Drenimi dhe mbledhja e (<i>leachate</i>) gazit dhe e ujit nga kullimi”). Një pompë me motor e lidhur me një tub fleksibël përdoret për të rishpërndarë (<i>leachate</i>) gazin dhe ujin nga kullimi, nëpër venddepozitime. Riqarkullimi i (<i>leachate</i>) gazit dhe i ujit nga kullimi është një mënyrë shumë pak e kushtueshme për të	








	përpunuar (<i>leachate</i>) gazin dhe ujin nga kullimi dhe për të mbrojtur mjedisin. Është e rëndësishme që të rifutet (<i>leachate</i>) gazi dhe uji që del nga kullimi, me shkarkim të ulët dhe duhet të mos tejkalojë kapacitetin e infiltrimit që ka venddepozitimi i mbetjeve, përndryshe lëngjet do të rrjedhin në sistemin e drenimit të ujit dhe do të drejtohet në mjedis pa u përpunuar. Rishpërndarja e shpeshtë e sasive të vogla të (<i>leachate</i>) gazit dhe ujit nga kullimi, preferohet më shumë se sa rishpërndarja e rrallë e sasive më të mëdha. Riqarkullimi i (<i>leachate</i>) gazit dhe i ujit që del nga kullimi është veçanërisht efikas në sezonet e nxehta ose të thata dhe më pak në dimër dhe në kohë me shi. Riqarkullimi kontribuon fort në reduktimin e komponentit organik të (<i>leachate</i>) gazit dhe të ujit që del nga kullimi dhe vendhedhja funksionon si një tretës organik. Avullimi dhe prodhimi i gazit kontribuon në reduktimin e sasisë së filtruar. Riqarkullimi i (<i>leachate</i>) gazit dhe i ujit që del nga kullimi rrit prodhimin e gazit dhe mund të gjenerojë më shumë erë të keqe. Për këtë arsye, riqarkullimi i (<i>leachate</i>) gazit dhe i ujit që del nga kullimi zakonisht kombinohet me sistemin e kapjes dhe të djegies së gazit.
--	--


ZBATIMI I PËRPUNIMIT TË (<i>LEACHATE</i>) GAZIT DHE UJIT NGA KULLIMI	Objektivat: Përpunimi i çlirimeve të (<i>leachate</i>) gazit dhe të ujit nga kullimi.	Risqet që lidhen me të: Ndotja e ujit sipërfaqësor; Ndotja e ujërave nëntokësore.
Përshkrimi	<i>Leachate</i> (gazi dhe uji nga kullimi) është lëngu mbetje që vjen nga filtrimi i ujit nëpërmjet një materiali një fraksion i të cilit mund të jetë i tretshëm, në këtë rast mbetjet. Niveli i ndotjes nga <i>leachate</i> (gazit dhe ujit nga kullimi) varet nga poroziteti i materialit dhe nga përbërja e tij. <i>Leachate</i> (gazi dhe uji nga kullimi) mund të ndotë tokën, ujërat nëntokësore dhe ujërat sipërfaqësore. Reshjet rrisin sasinë e (<i>leachate</i>) gazit dhe e ujit nga kullimi. Për një venddepozitim mund të thuhet që 60% e reshjeve kalon mes mbetjeve dhe bëhet <i>leachate</i> (gaz dhe ujë që del nga kullimi). Për një venddepozitim të mbuluar me materiale inerte, rrjedhja e ujit është më e madhe dhe si rezultat <i>leachate</i> (gazi dhe uji nga kullimi) do të jetë rreth 40% të reshjeve. Për një venddepozitim të rregullt me pjerrësi minimalisht prej 5–10%, drenimi sipërfaqësor dhe i mbuluar me materiale inerte, <i>leachate</i> (gazi dhe uji nga kullimi) mund të llogaritet deri në 20% të reshjeve vjetore. Në varësi të përbërjes së mbetjeve në venddepozitimin e mbetjeve dhe sasisë së shiut, ndryshojnë dhe karakteristikat e (<i>leachate</i>) gazi dhe e ujit nga kullimi. <i>Leachate</i> (gazi dhe uji nga kullimi) që nuk mund të riqarkullohen duhet të grumbullohen dhe përpunohen. Lidhja me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza: Kur është e mundur, mënyra më e thjeshtë për të përpunuar (<i>leachate</i>) gazin dhe ujin nga kullimi, e venddepozitimit është duke i lidhur ato me sistemin e kanalizimeve urbane të ujërave të zeza. Përpunimi i avullimit <i>leachate</i> (gazi dhe uji nga kullimi) largohen në një pellg për grumbullimin e tyre. Zgjidhja më e thjeshtë është përdorimi i një pellgu avullimi për të avulluar <i>leachate</i> (gazin dhe ujin nga kullimi) falë diellit dhe erës. Kjo lloj teknike është efikase kur ka reshje të ulta dhe avullim të lartë, dhe është shumë e përshtatshme në klima të thata. <i>Leachate</i> (gazi dhe uji nga kullimi) mund të avullojnë gjithashtu edhe nga vendhedhja nëse zbatohet riqarkullimi i (<i>leachate</i>) gazit dhe i ujit nga kullimi (shiko “zbatimi i masës së riqarkullimit të (<i>leachate</i>) gazit dhe të ujit nga kullimi”). Filtri anaerobik dhe aerobik: Direkt nga venddepozitimi ose pas riqarkullimit apo pellgut të avullimit apo një rezervuari, kanalet kulluese mund të lidhen me një filtër fizik bazë anaerobik, me këto dimensione: një ose më shumë basene me një gjatësi 10 m, gjerësi 3 m, thellësi 1m, mbushur me zhavorr, me një gradient granulometrie, siç jepet në figurën e mëposhtme. Koha e qëndrimit duhet të jetë minimalisht 9 orë për të siguruar përpunimin e 80% të ndotjes organike dhe nga 1 deri në 2 ditë për të arritur në 90%. Rekomandohet që filtri anaerobik të plotësohet me një filtër aerobik, ku uji rrjedh poshtë, nëpër zhavorrin e ajrosur (32/50 mm dhe më të madh), me një gradient lartësie për të oksigjenuar lëngjet, para se ato të çlirohen në lumë apo liqen. Filtrat aerobikë janë të pastruara gjatë gjithë kohës. Basenet e filtrit mund të ndërtohen me çdo material kundër ujit (beton, veshje plastike etj.). Materiali filtër duhet të jetë i qëndrueshëm brenda filtrit dhe nuk duhet ta marrë rrjedhja e <i>leachate</i> (gazi dhe uji nga kullimi). Nuk ka nevojë për një pengesë fizike ndërmjet materialeve me diametër të ndryshëm. Në rast se materiali mobilizohet, është i mjaftueshëm përdorimi i një rrjete për të ndarë materialin por duke lënë ujin të rrjedhë.	



NDËRTIMI I DIGAVE PËR STABILITETIN E MBETJEVE	Objektivat: Stabilizimi i mbetjeve; Përbëjnë një barrierë rreth mbetjeve. Lejon të fshehtë operimin e venddepozitimit të mbetjeve, duke reduktuar ndikimin në peizazh; Lejon operimin e venddepozitimit në shtresa (kursen hapësirën).	Risqet që lidhen me to: Shpërndarja e mbetjeve; Përdorimi i tokës.
Përshkrimi	Digat janë objekte mbështetëse me përmasa fikse, të cilat ndërtohen rreth vendit ku do të hidhen mbetjet. Digat përdoren për të kufizuar kufijtë e venddepozitimit, për të stabilizuar mbetjet brenda tij dhe për të lejuar mbushjen e venddepozitimit me shtresa. Në një zonë të sheshtë, çdo shtresë është më e vogël se shtresa më poshtë, kështu që në fund venddepozitimi do të ketë formën e një “mali”. Diga ka një pjerrësi maksimalisht prej 2:3 dhe me një lartësi maksimale prej 2.5 m, për të garantuar stabilitetin. Është e rëndësishme të vëmë në dukje që stabiliteti mund të ndryshojë në varësi të llojit të materialit, por pirgjet nuk duhet të jenë asnjëherë më të pjerrëta sesa 2:3. Materialët që përdoren për ndërtimin e digave mund të jenë material ndërtimi (tulla, gurë, beton i thyer etj.) ose edhe mbetje të zgjedhura. Pas ndërtimit të digës, duhet të përdoret një shtresë dheu prej të paktën 0.2 m trashësi për të mbuluar pjesën e jashtme të digave, për të shmangur erozionin, për të lehtësuar vegjetimin dhe për të integruar këtë strukturë në peizazhin rrethues. Nuk është e nevojshme të ndërtohet një digë nëse aty ka mure (ose reliev natyrore). Kur arrihet deri te niveli i murit/relievit natyror atëherë sipër saj vendoset një digë.	
Plane/figura	 Figura 5. Digat (me ngjyrë jeshile) vendosen për të kufizuar dhe stabilizuar mbetjet që do të hidhen. Vija e zezë përfaqëson formën e mëparshme të venddepozitimit, para modelimit të saj me diga.	
NDËRTIMI I PENGESAVE PËR MBROJTJE/STABILIZIM	Objektivat: Të vendosen kufijtë dhe limiti i zonës së venddepozitimit; Të stabilizojë mbetjet nga faktorët e jashtëm (p.sh., lumi); Të shmangë që venddepozitimi të jetë i dukshëm.	Risqet e lidhura me të Stabiliteti i mbetjeve dhe risku në lidhje me objekte sensitive; Lëvizja e mbetjeve për shkak të periudhave me shumë ujë.
Përshkrimi	Pengesat ndërtohen që të mbahen mbetjet ose për të mbrojtur mbetjet nga agjentë të jashtëm si përmytjet, por edhe për të mbrojtur objektet sensitive të vendosura në rrjedhën e poshtme, si për shembull: shtëpi, lumenj apo ndërtesa të tjera. Në varësi të riskut të gjendjes specifike, mund të merren në konsideratë veprime të ndryshme: Para se të ndërtohet një pengesë, pirgjet e mbetjeve duhet të përshtaten ose në rastet kur mbetjet janë duke shkaktuar rreziqe (si për shembull, mbetjet në shtretërit e lumenjve), ato duhet të largohen. Stabilizimi i pirgjeve mund të zbatohet edhe si masë parandaluese. Nëse do të ndërtohet një pengesë mbrojtëse, ajo duhet të jetë një strukturë e rëndë dhe e qëndrueshme. Përdorimi i togjeve me gurë të mbushur me gurë të rëndë siguron stabilitetin dhe përshkueshmërinë që kërkohet. Në rastin kur nevojitet mbrojtja nga përmytjet, mund të vendoset zhavorr i trashë në fund të togjeve me gurë për të ulur erozionin dhe si rezultat dhe destabilizimin e gabionëve (togjeve me gurë).	

Plane/figura → Përshtatja/rregullimi i përgut → Pjerrësia maksimale → Për t'u larguar	Slope adaption  Figura 6. Rrezik për shtëpitë: stabilizimi i mbetjeve me një rregullim të përgut. Rasti (A) paraqet një risk të madh kolapsi. Edhe nëse nuk vihet në funksionim, sipërfaqja e venddepozitimit do të modelohet deri në një pjerrësi maksimale prej 2:3.  Figura 7. Mbetjet e vjetra të depozituara dhe materiali që ka marrë pjerrësinë e stabilitetit. Vazhdimi i funksionimit mund të realizohet mbi strukturën e vjetër, pasi mbetjet poshtë janë ngjeshur tashmë. Një drenim periferik duhet të instalohet në fund të përgut për të larguar ujin e shiut dhe për të parandaluar destabilizimin e mbetjeve.  Figura 8. Nëse ka mbetje në shtratin e lumit, ato duhet të largohen dhe duhet vendosur pengesa e mbrojtjes mbi nivelin e ujit për të rritur stabilitetin e strukturës; materiali prej zhavorr të trashë mund të depozitohet në bazën e pengesës, nga ana e lumit. Kjo do të mbrojtë pengesën në rast përmbytjesh. Një sistem kullimi për <i>leachate</i> (gazin dhe ujërat nga kullimi) do të vendoset në pjesën e brendshme të pengesës për të shmangur grumbullimin e (<i>leachate</i>) gazit dhe të ujit nga kullimi dhe destabilizimin e murit.		
ZBATIMI I SISTEMIT TË LARGIMIT TË GAZIT	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="454 1736 869 2004"> Objektivat: Reduktimi i çlirimeve të gazit dhe erës së keqe nga venddepozitimi i mbetjeve; Reduktimi i ndikimit në cilësinë e ajrit dhe efektin e gazeve të serrave në klimën globale; Shmangia e risqeve për rënie zjarresh; Rikuperimi i energjisë. </td><td data-bbox="869 1736 1457 2004"> Risqet që lidhen me të: Shpërthime gazi/marrja flakë; Erë e keqe e fortë. </td></tr> </table>	Objektivat: Reduktimi i çlirimeve të gazit dhe erës së keqe nga venddepozitimi i mbetjeve; Reduktimi i ndikimit në cilësinë e ajrit dhe efektin e gazeve të serrave në klimën globale; Shmangia e risqeve për rënie zjarresh; Rikuperimi i energjisë.	Risqet që lidhen me të: Shpërthime gazi/marrja flakë; Erë e keqe e fortë.
Objektivat: Reduktimi i çlirimeve të gazit dhe erës së keqe nga venddepozitimi i mbetjeve; Reduktimi i ndikimit në cilësinë e ajrit dhe efektin e gazeve të serrave në klimën globale; Shmangia e risqeve për rënie zjarresh; Rikuperimi i energjisë.	Risqet që lidhen me të: Shpërthime gazi/marrja flakë; Erë e keqe e fortë.		
Përshkrimi	Ndërsa mbetjet dekompozohen, gjenerohet gaz. Gazi do të fillojë të çlirohet brenda pak javësh që nga fillimi i depozitimit të mbetjeve dhe mund të gjenerohet për dekada të tëra edhe		

	pas mbylljes së venddepozitimit të mbetjeve. Mbetjet në venddepozitim prodhojnë gaz me anë të dekompozimit biologjik në kushte anaerobike (pa oksigjen). Gazet përmbajnë një sasi të madhe metani (CH_4), që është dhe shkaku i rënies së zjarreve apo të shpërthimeve nëse grumbullohet në xhepat e gazit. Akumulimi i gazit mund të shkaktojë dhe asfiksi. Sistemi i evakuimit të gazit duhet të planifikohet si një seri oxhakësh të vendosur afërsisht çdo 20 metra, të ndërtuar me tuba metalikë të mbushur me gurë apo materiale inerte (përshkueshmëri e lartë). Struktura metalike me doreza instalohet paraprakisht te depozitimi i mbetjeve dhe mbushet me material të trashë. Kur niveli i mbetjeve arrin pjesën lart të tubit metalik, përdorni një makinë për të tërhequr lart tubin metalik, siç tregohet në figurë dhe mbushet sërish me gurë. Në rast se nuk ka makinë për këtë qëllim, kjo mund të realizohet dhe me dorë edhe pse kërkon fuqi. Materialet inerte do të mbeten në shtresën e mbetjeve, duke krijuar një mënyrë preferenciale të qarkullimit të gazit. Tubi i ngritur duhet të mbushet me material të trashë, para se të hidhen mbetjet rreth e rrotull saj. Oxhaku duhet të ketë një “gyp të fiksuar mbrapsht” për ta përqendruar gazin në një pikë ku do të ndizet për të djegur gazin e prodhuar nga mbetjet e asgjësuar. Ky gyp hiqet kur oxhaku tërhiqet lart.		
Plane/figura	 Figura 9. Operatori duke mbushur venddepozitimin, duke pasur kujdes për të mos dëmtuar oxhakun e gazit. Një gyp vendoset mbrapsht në krye të oxhaqeve për të përqendruar çlirimin e gazeve dhe për ta ndezur (djegur atë). Çlirimi i gazit nga një venddepozitim në një tjetër ndryshon. Djegia e gazit duhet të bëhet nën mbikëqyrje të rreptë dhe stafi duhet të jetë i informuar dhe i trajnuar për këtë praktikë specifike.  Figura 10. Zbatimi i oxhaqeve të gazit mund të bëhet me dorë ose me anë të përdorimit të makinave.		
ZBATIMI I MBULIMIT FINAL DHE I MBYLLJES SË VENDDEPOZITIMIT	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="451 1816 949 2072"> Objektivat: Siguria afër një venddepozitimi të mbetjeve që nuk përdoret më; Moslejimi i përdoruesve të hyjnë në venddepozitimin e mbetjeve dhe për të pasur kontakt me mbetjet; Rikthimi i florës lokale/vegjetimit/peizazhit natyror. </td><td data-bbox="949 1816 1457 2072"> Risqet e lidhura me të: Përdorim i vazhdueshëm i venddepozitimit; Kontakti i njerëzve dhe i kafshëve me ndotjen e mundshme; Krijimi i barrierave shtesë për mbrojtje dhe integrimi i venddepozitimit në peizazh. </td></tr> </table>	Objektivat: Siguria afër një venddepozitimi të mbetjeve që nuk përdoret më; Moslejimi i përdoruesve të hyjnë në venddepozitimin e mbetjeve dhe për të pasur kontakt me mbetjet; Rikthimi i florës lokale/vegjetimit/peizazhit natyror.	Risqet e lidhura me të: Përdorim i vazhdueshëm i venddepozitimit; Kontakti i njerëzve dhe i kafshëve me ndotjen e mundshme; Krijimi i barrierave shtesë për mbrojtje dhe integrimi i venddepozitimit në peizazh.
Objektivat: Siguria afër një venddepozitimi të mbetjeve që nuk përdoret më; Moslejimi i përdoruesve të hyjnë në venddepozitimin e mbetjeve dhe për të pasur kontakt me mbetjet; Rikthimi i florës lokale/vegjetimit/peizazhit natyror.	Risqet e lidhura me të: Përdorim i vazhdueshëm i venddepozitimit; Kontakti i njerëzve dhe i kafshëve me ndotjen e mundshme; Krijimi i barrierave shtesë për mbrojtje dhe integrimi i venddepozitimit në peizazh.		

Përshkrimi	Mbulimi final garanton mbylljen e sigurt të operimit pasi krijon një barriërë mes mbetjeve dhe popullsisë ose faunës. Përveç kësaj, ai favorizon integrimin në peizazh, duke rikrijuar një mbulesë vegjetacioni dhe kufizon sasinë e ujit që hyn në venddepozitimin e mbetjeve dhe prodhon <i>leachate</i> (gaz dhe ujë nga kullimi). Venddepozitimi i mbyllur nevojitet të mbulohet plotësisht me 80 centimetra material drenimi dhe 30 centimetra dhé: Materiali i drenimit konsiston në zhavorr ose gurë ose materiale të përzgjedhura ndërtimi (tulla, gurë, beton i thyer etj.). Diametri duhet të jetë ndërmjet 3 mm dhe 15 mm. Qëllimi i vendosjes së dheut është stabilizimi i materialit të drenimit dhe për të mundësuar zhvillimin e vegjetacionit në sipërfaqen e venddepozitimit të mbetjeve. Është e rëndësishme të mirëmbahen pirgjet e venddepozitimit edhe pas mbylljes së venddepozitimit të mbetjeve, për të shmangur akumulimin e ujit te mbetjet dhe riskun që vjen nga kjo, atë të destabilizimit dhe të ndotjes së ujit. Gjithashtu, është e rëndësishme të zbatohen mënyrat për rrjedhjet e ujit me qëllim që të kontrollohet erozioni nga uji. Nëse ka oxhaqe gazi, ato duhet të mbahen me qëllim që të garantojnë evakuimin e gazit edhe pas mbylljes, dhe për të shmangur akumulimin e gazit në venddepozitimin e mbetjeve. Nëse ato nuk janë prezent këshillohet që të krijohen, me qëllim që të shmanget akumulimi i gazit dhe si rezultat gjenerimi i riskut.
Plane/figura	 Figura 11. E gjithë sipërfaqja e venddepozitimit të mbetjeve duhet të mbulohet. Duhet të instalohen oxhaqe gazi në pikat më të larta për të shmangur akumulimin e gazit nën shtresën finale të mbulimit. Instalohet një gyp metalik mbrapsht pasi mbyllet venddepozitimi i mbetjeve me qëllim që të përqendrohen gazrat që çlirohen dhe të mundësohet kontrolli i ndezjes së tyre (djegies). Ky veprim duhet të zbatohet duke marrë në konsideratë të gjitha masat e sigurisë dhe të ruajtjes.

KUSHTET MINIMALE OPERACIONALE

Operimi i përgjithshëm

Kur zbatohen masat fizike, operimi i venddepozitimit mund të organizohet sipas standardeve të mëposhtme minimale të operimit me qëllim që të garantohet jetëgjatësia e masave fizike që janë ndërmarrë dhe për të përmirësuar ruajtjen dhe sigurinë e operimit:

Prania dhe respektimi i një plani asgjësimi: mbetjet asgjësohen sipas një plani, i cili tregon venddepozitimin e asgjësimit, nevojën e ndarjes (d.m.th., materiale ndërtimi apo inerte që më vonë përdoren për mbulim) dhe trashësinë dhe gjerësinë e shtresës. Qëllimi i planit të asgjësimit është të minimizojë ndikimin ndërkohë që optimizon përpjekjet e operimit.

Faqe | 6206

Qarkullimi i kamionit duhet të jetë i organizuar dhe i sinjalizuar (nëpërmjet koneve plastike apo mjete të tjera të ngjashme), me qëllim që të kontribuojnë në ngjeshjen e mbetjeve.

Mbetjet asgjësohen direkt në vend nga kamionët, në fasha prej 3 m deri në 5 m të gjera, 2 deri në 3 m në thellësi.

Mbulimi i mbetjeve të depozituara së fundmi çdo ditë ose javë, me 0.15 m dhé ose inerte të tjera ose materiale ndërtimi.

Hendeqet dhe kanalet e kullimit duhet të mbahen të pastra për të shmangur bllokimin e tyre në kohë me shi.

Hyrja në venddepozitimin e mbetjeve, si dhe porta dhe gardhet, duhet të mirëmbahen për të bërë të mundur që klientët të depozitojnë mbetjet



shpejt dhe me rregull dhe të ndalohet prania e kafshëve dhe njerëzve jo të autorizuar.

Regjistrimi i dorëzimit të mbetjeve dhe pagesat e tarifave hyrëse, nëse ka.

Plani i asgjësimit

Mbetjet duhet të hidhen në një mënyrë të organizuar, që realizohet nga operatori përgjegjës, në shtresa prej 2 deri në 3 m të trasha.

Për të minimizuar ujin e shiut që infiltrohet te mbetjet, zona e operimit duhet të jetë minimale. Për këtë arsye, rendi i veprimeve me mbetjet hyrëse duhet të planifikohet dhe venddepozitimi duhet të ndahet në qeliza.

Qelizat mbushen me mbetje, njëra pas tjetrës. Një qelizë i korrespondon sasisë së mbetjeve që hidhet çdo ditë.

Mbuloni qelizën me materiale inerte çdo ditë pune.

Filloni me qelizat në pikat më të largëta për të siguruar një qarkullim më të thjeshtë me automjetin tuaj.

Mbulimi që kryhet çdo ditë

Sipërfaqja e hapur që përdoret për hedhjen e mbetjeve duhet të jetë shumë e kufizuar. Të gjitha sipërfaqet e tjera joaktive duhet të mbulohen me dhé ose mbetje inerte.

Ky mbulim është shumë efikas: për të reduktuar infiltrimin e ujit të shiut, për të reduktuar infektimet nga insektet, për të ulur tërheqjen e zogjve, minjve dhe kafshëve të tjera si rezultat i mbetjeve, për të parandaluar rënien e zjarreve, për të dekurajuar, për të reduktuar ekspozimin ndaj kushteve atmosferike, për të reduktuar shtyrjen nga era të mbetjeve plastike nëpër venddepozitimin e mbetjeve.

Mbetjet duhet të mbulohen rregullisht me 15 cm mbetje inerte apo dhera, nëse është e mundur të bëhet çdo ditë (ose çdo javë minimumi).

Për të zbatuar mbulimin në venddepozitim duhet të ketë material të disponueshëm. Ai mund të variojë nga materiale inerte në mbetje nga ndërtimet dhe nuk ka kërkesa specifike për to, megjithëse duhen eliminuar materiale organike apo elemente të lehta (plastika, letra etj.).

Ky mbulim mundëson qarkullimin e kamionëve të cilët ngjeshin mbetjet.

Monitorimi i ndikimit në venddepozitimin e mbetjeve

Me qëllim që të vlerësohet nëse një venddepozitim paraqet një risk apo jo ose nëse

ka një ndikim të caktuar, nevojitet të kryhet një monitorim rutinë për të gjitha elementet e pranishme në venddepozitimin e mbetjeve. Kjo ka si qëllim vëzhgimin sistematik të ndikimit të mundshëm të një venddepozitimi mbetjesh dhe të organizojë masat që lidhen me ndikimin që keni vlerësuar.

Monitorimi ul riskun e neglizhimit të rreziqeve potenciale në venddepozitimin e mbetjeve, si për shembull:

Kolapsi i brendshëm i venddepozitimit të mbetjeve;

Kolapsi i venddepozitimit të mbetjeve, shpërthimi i digës;

Përmbytja e venddepozitimit të mbetjeve ose krijimi i “pellgjeve” në sipërfaqe;

Djegia e venddepozitimit të mbetjeve;

Mbyllja e venddepozitimit të mbetjeve për shkak se nuk ka më hapësirë të disponueshme.

Lista e kontrollit për monitorimin duhet të përmbajë veprimet e mëposhtme:

Monitorimi i gjendjes në tërësi të venddepozitimit;

Monitorimi i gjendjes së digës kryesore;

Monitorimi i gjendjes së murit mbajtës;

Monitorimi i rrjedhës brenda dhe jashtë tubave të venddepozitimit të mbetjeve;

Monitorimi i gjendjes së gardhit;

Monitorimi i sistemit të kullimit;

Monitorimi i sistemit të çlirimit të gazit;

Monitorimi i përputhshmërisë me modelin e shtresëzimit që është vendosur për venddepozitimin e mbetjeve;

Monitorimi i pjerrësisë së sipërfaqes së mbetjeve që duhet respektuar (5–10%), me qëllim që të mundësohet largimi i rrjedhës së ujit sipërfaqësor.

Monitorimi duhet të përmbledhet në një raport të thjeshtë, ku vendoset data, si dhe shënimet e nevojshme në lidhje me pikat e përmendura më sipër.

**VENDIM****Nr. 390, datë 27.6.2018****PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 16.2.2017,
PËR ÇËSHTJEN “RUSHITI KUNDËR
SHQIPËRISË” (KËRKESA NR. 23136/13)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Rushiti kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 23136/13), në shumën 1 800 euro (një mijë e tetëqind euro), lidhur me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, duke e përjashtuar nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkueses znj. Selvie Rushiti, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Rushiti kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 23136/13).

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të kërkueses, znj. Selvie Rushiti, të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga data kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Për mospagim brenda afatit tremujor të përmendur në pikën 4 të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikat 1 e 5 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Senida Mesi****VENDIM****Nr. 391, datë 27.6.2018****PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 21.4.2016,
PËR ÇËSHTJEN “TOPALLAJ KUNDËR
SHQIPËRISË” (KËRKESA NR. 32913/03)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 21.4.2016, për çështjen “Topallaj kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 32913/03), në shumën 1 000 (një mijë) euro, në lidhje me dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.



3. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesit, z. Marketin Topallaj, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 21.4.2016, për çështjen “Topallaj kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 32913/03).

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të kërkuesit, z. Marketin Topallaj, të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor, nga data kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Për mospagimin brenda afatit tremujor, të përmendur në pikën 4 të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë, të barabartë me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikat 1 dhe 5 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 392, datë 27.6.2018

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 16.2.2017,
PËR ÇËSHTJEN “HATIJA KUNDËR
SHQIPËRISË” (KËRKESA NR. 53103/15)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të

nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Hatija kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 53103/15), në shumën 1 000 euro (një mijë euro), për kërkuesin, z. Shkëlqim Hatija, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, duke e përjashtuar nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesit, z. Shkëlqim Hatija, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Hatija kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 53103/15.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të kërkuesit, z. Shkëlqim Hatija, të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga data kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Për mospagim brenda afatit tremujor, të përmendur në pikën 4 të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikat 1 e 5 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**VENDIM****Nr. 394, datë 27.6.2018**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 440, DATË 17.5.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE, TË
KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË
AKREDITIMIT TË OFRUESVE TË
AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË
VAZHDIM PËR PROFESIONISTËT E
SHËNDETËSISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 33/1, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 440, datë 17.5.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në ndarjen I bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas shkronjës “ç”, të pikës 5, shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

d) “Të publikojë periodikisht informacionet e lidhura me aktivitetet e ofruesve të akredituar nga QKEV-ja. Këto informacione t’u jepen profesionistëve të shëndetësisë dhe strukturave e institucioneve shëndetësore, për të ndikuar në pjesëmarrjen sa më të gjerë të të interesuarve.”.

b) Pika 4, e ndarjes IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Ofruesi duhet të ketë një përvojë të provueshme nga QKEV-ja ose nga institucione të tjera akredituese në një vend tjetër të BE-së ose OECD-së prej të paktën 1 (një) viti në fushën e edukimit në vazhdim në Shqipëri dhe me jo më pak se 50 aktivitete të akredituara në fushën e edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.”.

c) Në fund të pikës 1, të ndarjes VI, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ofruesi i akredituar duhet të njoftojë QKEV-në 3 (tri) ditë pune përpara zhvillimit të aktivitetit për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të tij.”.

II. Ngarkohet QKEV-ja dhe të gjithë ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për

profesionistët e shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

URDHËR**Nr. 480, datë 25.6.2018****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Arian Kraja, Sekretar i Përgjithshëm:

a) Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjykit, duke përfshirë: kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykit të kësaj çështjeje, si dhe t’i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga z. Arian Kraja, Sekretar i Përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

b) Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

c) Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për procedurat e koncesioneve dhe partneritetin publik privat me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



d) Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

e) Të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

f) Të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit.

g) Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen na z. Arian Kraja, Sekretar i Përgjithshëm, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

4. Ngarkohet z. Arian Kraja, Sekretar i Përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 342, datë 23.4.2018, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 421 (1773), datë 16.4.2018, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetases Dhurate Qazim Nikshiqi, e datëlindjes 22.1.1954, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të shtetases Lejla Nikshiqi.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 829, datë 11.6.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Edmond Dinaku, i datëlindjes 27.4.1964, duke përcaktuar si datë të zhdukjes datën 15.8.1995.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë